

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6354
E shtunë, 3 korrik 2021
çmimi 0.40 €

47 për qind e qytetarëve të Prishtinës kanë qenë të infektuar me Covid

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FORUMI I PRESPËS PËR DIALOG KA VAZHDUAR PUNIMET EDHE TË PREMTEN | FAQE 4-5

KOSOVA DHE SHQIPËRIA TË ZHGËNJYERA ME QASJEN E BE-së



Kosova dhe Shqipëria janë ankuar në qasjen e Bashkimit Evropian ndaj këtyre dy vendeve dhe Ballkanit Perëndimor në përgjithësi. Në ditën e dytë të konferencës ndërkombëtare "Prespa Forum", kryeministri Albin Kurti ka vlerësuar se Kosova është e zhgënjyer me BE-në për mosliberalizim të vizave dhe

për moshapje të negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ndaj BE-së ankesa ka pasur edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe kryeministrat e tjerë të vendeve të rajonit që kanë marrë pjesë në këtë forum. Sipas tyre, pavarësisht prej zhgënjimit, BE-ja mbetet alternativë e vetme për rajonin

OPINION

PSE PO SULMOHET TURIZMI NË SHQIPËRI NGA VETË SHQIPTARËT? F. 8-9

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA




AKTUALE



ZBULOHET PLLAKA PËRKUJTIMORE PËR DEKLARATËN KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT F. 7

DY VIKTIMA DHE 17 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 7

EKONOMI



CARITAS-i OFRON PËRKRRAHJE PËR FERMERËT F. 10

SOT MBAHET KONVENTA E DHJETË E PDK-së, KRASNIQI I VETMI KANDIDAT PËR KRYETAR PARTIE



FAQE 3



DHJETËRA TË ARRESTUAR NË SHQIPËRI PËR TRAFIK DROGE DHE KORRUPSION F. 7

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MURATI NË TAKIMET VJETORE TË BERZH-it KËRKON QASJE PROAKTIVE NDAJ SEKTORIT PRIVAT F. 10

Dhjetëra të arrestuar në Shqipëri për trafik droge dhe korrupsion

TIRANË, 2 KORRIK- Autoritetet e Shqipërisë kanë njoftuar se përmes një operacioni kanë arrestuar rreth 38 persona për trafik droge, korrupsion, keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe pastrim parash. Në mesin e të arrestuarve janë një prokuror, një drejtues i një departamenti qeveritar dhe tre oficerë policie, raporton AP. Struktura e Posaçme e Shqipërisë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e njohur si SPAK, tha se në bazë të një hetimi dyvjeçar, i udhëhequr nga Italia, u dëshmuar se të

dysuarit ishin pjesë e katër grupeve ndërkombëtare të krimit, të përfshira kryesisht në trafikun e drogës dhe se ata vepronin në Shqipëri, Itali, Mal të Zi dhe Spanjë. Njëzet e tetë prej të dyshuarve, përfshirë dy truproja që kanë punuar për një ish-ministër të Brendshëm shqiptar, u arrestuan në Shqipëri. “Zyrtarët publikë, në disa raste vetë pronarë të drogës, kishin garantuar që lëndët narkotike të destinuar për rajonin italian të Puglias do të mbërrinin atje sigurt ose nga toka ose deti”, thuhet në

deklaratën për media. Autoritetet shqiptare do të konfiskojnë pasuri në vlerë të miliona eurove nga pasuria e të dyshuarve, përfshirë apartamente, patundshmëri të ndryshme dhe biznese të tjera. Shqipëria dikur ishte një vend prodhues kryesor evropian i marijuanës dhe një pikë kyçe e kontrabandës së saj. Shtatë vjet më parë, për shkak të një fushate të autoriteteve, u ul ndjeshëm numri i plantacioneve të kanabisit, por operacionet e vazhdueshme kundër trafikut të drogës



dëshmojnë se trafikantët ende kërkojnë vende alternative për të rritur ose ruajtur marijuanën dhe janë bërë

pjesë e rrjeteve ndërkombëtare të trafikut të lëndëve të tjera narkotike më të forta.

ShBA-ja vendos moratorium mbi ekzekutimet federale



UASHINGTON, 2 KORRIK- Departamenti amerikan i Drejtësisë lëshoi një moratorium mbi ekzekutimet federale, pasi rishikoi politikat dhe procedurat e dënimit me vdekje. Prokurori i përgjithshëm, Merrick Garland, tha se “Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë që secili në sistemin federal të drejtësisë penale, jo vetëm që i ka të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligjet amerikane por, gjithashtu, trajtohet në mënyrë të drejtë dhe njerëzore”. “Ky detyrim ka fuqi të veçantë në rastet e

dënimit kapital”, ka thënë Garland. Në muajt e fundit të administratës së ish-presidentit amerikan Donald Trump, Byroja e Burgjeve në ShBA ka kryer 13 ekzekutime. Vargu i ekzekutimeve, më i gjati nën një president në 120 vjet, është bërë pasi ish-prokurori i përgjithshëm, William Barr, ka rinisur përdorimin federal të dënimit me vdekje, pas një ndërprerjeje 17-vjeçare. “Janë ngritur shqetësime serioze në lidhje me përdorimin e vazhdueshëm të dënimit me vdekje në të

gjithë vendin”, ka thënë Garland në deklaratën ku njoftoi për moratoriumin. Këto përfshijnë “mënyrën arbitrare të zbatimit të tij, ndikimin e ndryshëm të njerëzimit me ngjyrë dhe raste të tjera të rënda”, ka theksuar Garland. Ekzekutimet federale janë ndërprerë për shkak të shqetësimeve në lidhje me një koktej me tri ilaçe, që është përdorur për një numër ekzekutimesh. Një nga ilaçet ka qenë vështirë të sigurohet, pasi ndërmarrjet farmaceutike kanë ndaluar shitjen e tij të qeveria.

Izraeli sulmoi Gazën, pasi Hamasi hodhi balona me flakë

JERUSALEM, 2 KORRIK- Avionët luftarakë të Izraelit sulmuan një lokacion të Hamasit për prodhimin e armëve në Gaza, pasi grupi militant hodhi balona me flakë në drejtim të Izraelit, tha të premtën ushtria izraelite. Raportime për viktima nga sulmet nuk ka. Është ky raundi i tretë i sulmeve

ajrore të Izraelit në Gaza, që nga përfundimi i konfliktit 11-ditësh midis forcave izraelite dhe militantëve të Hamasit, në muajin maj. Të gjitha sulmet janë kryer në përgjigje të balonave të Hamasit, që kanë shkaktuar zjarre në tokat bujqësore izraelite. Ushtria izraelite dhe Hamasi kanë zhvilluar katër luftëra të

mëdha. Mosmarrëveshjet e tyre kanë bërë me kontrollin e territoreve. Konflikti i fundit, në muajin maj, ka lënë 260 palestinezë të vrarë, sipas autoriteteve në Gaza. Në Izrael janë vrarë 13 njerëz. Armëpushimi pastaj është ndërmjetësuar nga Egjipti.



Rusia përballet me treg të zi të certifikatave të vaksinimit



MOSKË, 2 KORRIK- Në Rusi po lëshohen gjithnjë e më shumë certifikata të rreme të vaksinimit kundër koronavirusit, si dhe teste negative për virusin, derisa ky vend po kalon nëpër valën më të rëndë të sëmundjes Covid-19, thanë autoritetet.

Zyrtarë të zbatimit të ligjit në Moskë thanë të premtën se kanë arrestuar një burrë, 33 vjeç, të dyshuar për shitjen e certifikatave të falsifikuara të banorët e qytetit. Policia në Shën Petersburg tha se ka nisur disa hetime kundër individëve që shesin certifikata

të rreme vaksinimi dhe teste të rreme PCR, që tregojnë praninë ose jo të koronavirusit në organizëm. Një ditë më herët, Rusia raportoi për 672 viktima nga koronavirusi brenda 24-orësh. Shifra ishte rekorde për të tretën ditë me radhë. Situata më e rëndë me

koronavirus është në Moskë dhe Shën Petersburg - dy qytetet më të mëdha të Rusisë. Shefi i Departamentit të Shëndetësisë në Moskë, Aleksei Khripun, u bëri thirrje të gjithë banorëve të kryeqytetit rus që të vaksinohen.

Sot mbahet konventa e dhjetë e PDK-së, Krasniqi i vetmi kandidat për kryetar partie

Sot (e shtunë) Partia Demokratike e Kosovës (PDK) do ta mbajë Konventën Zgjedhore në të cilën do ta zgjedhë kryetarin e ri. Kandidaturën për kryetar të PDK-së e ka paraqitur vetëm Memli Krasniqi. Zyrtari i lartë i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se kjo parti me zgjedhjen e kryetarit të ri do të dalë më e fuqishme



shtunë) nga ora 09:30 në hotelin "Emerald". Kjo konventë është e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë do të jetë ceremoniale dhe ftohen

mediat ta përcjellin këtë ngjarje. Në konventë do të marrin pjesë 794 delegatë. Sipas afatit të përcaktuar në ditën e shpalljes së

zgjedhjeve, deri të enjten në orën 17:00 kandidaturën për kryetar të partisë e ka paraqitur vetëm Memli Krasniqi.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 KORRIK - Nën kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Kosovës, Bedri Hamza, në një konferencë për media, ka folur lidhur me mbajtjen e Konventës së dhjetë të PDK-së për zgjedhjen e kryetarit të ri të partisë. Hamza ka theksuar se në këtë konventë që do të mbahet nesër, gara për të kandiduar për kryetar të partisë ka qenë e hapur, ndonëse është paraqitur vetëm Memli Krasniqi, i cili zotëron integritet të lartë profesional dhe politik për këtë pozitë, si dhe ka marrë përkrahjen e të gjithë anëtarëve dhe strukturave. "Ka qenë një proces i hapur. Të gjithë ata që kanë pasur

dëshirë dhe gatishmëri kanë mundur të hyjnë në garë për t'u zgjedhur si kryetar i PDK-së. Aktualisht e kemi një kandidat dhe ai është Memli Krasniqi, një personalitet i cili i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhur kryetar i PDK-së", ka thënë Hamza. Ai ka theksuar se PDK-ja ka treguar qëndrueshmëri edhe pse ka qenë e goditur nga shkuarja e kryetarit Veseli dhe presidentit Thaçi në Hagë. "Është një proces për ta zgjedhur një kryetar i cili e kthen PDK-në fuqishëm drejt fitores për ta qeverisur vendin. Ne kemi treguar qëndrueshmëri dhe kemi arritur të jemi partia më e madhe opozitare", ka thënë Hamza.

Konventa e dhjetë e Partisë Demokratike të Kosovës për zgjedhjen e kryetarit të ri të partisë do të mbahet sot (e

47 për qind e qytetarëve të Prishtinës kanë qenë të infektuar me Covid

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 KORRIK - Komuna e Prishtinës ka paraqitur të premtën gjetjet e dy hulumtimeve në lidhje me pandeminë Covid-19 në kryeqytet. Me këtë rast, kryetari i kësaj komune, Shpend Ahmeti, ka thënë se, pas hulumtimeve që kanë bërë, ka dalë se rreth 47 për qind e qytetarëve të komunës së Prishtinës kanë qenë të infektuar me Covid-19. "Faktet

kryesore të cilat janë për qytetarët është se rreth 47 për qind e qytetarëve të komunës së Prishtinës kanë dalë pozitivë me Covid. 48 për qind e punëtorëve shëndetësorë janë pozitivë ose me test serologjik ose me PCR. 17 për qind janë serologjik pozitivë, ndërsa rreth 39 për qind pozitivë me test PCR. Nga punëtorët tanë në QKMF, pak mjekë ka pasur që nuk kanë qenë të infektuar", ka thënë ai. Ahmeti ka treguar se rreth 21 për qind e punëtorëve komunalë kanë dalë pozitivë në

testin serologjik. Pavarësisht që kanë rënë numrat e të infektuarve, kryetari Ahmeti ka thënë se vaksinimi është i domosdoshëm. "Vaksinimi është i domosdoshëm. Është e vërtetuar shkencërisht dhe e vërtetojnë të gjitha shtetet nga Perëndimi dhe Lindja, se vaksinimi është i domosdoshëm pavarësisht se rreth 50 për qind e kanë kaluar Covid-in. Qytetarët duhet të vazhdojnë të kenë kujdes", ka thënë kryetari Ahmeti.

Anëtarët e Komisionit për Shëndetësi vizituan Klinikën e Psikiatrisë dhe Institutin e Psikiatrisë Forenzike

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, dr. Valbon Krasniqi, bashkë me profesionistë shëndetësorë nga Klinika e Psikiatrisë dhe Instituti i Psikiatrisë Forenzike, kanë pritur në takim anëtarët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Gjatë takimit është diskutuar në lidhje me zbatimin e Ligjit 05/L-025 për Shëndetin Mendor, sukseset dhe sfidat në trajtimin e pacientëve. Drejtori Krasniqi i ka njoftuar anëtarët e komisionit lidhur me punën që zhvillohet në Klinikën e Psikiatrisë dhe Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Ai ka folur për sfidat me të cilat

ballafaqohen institucionet që menaxhohen nga ShSKUK-ja, që merren me shëndetin mendor.

Gjatë takimit me mjekë dhe profesionistë të fushës së shëndetit mendor në këto dy institucione, anëtarët e komisionit u njoftuan për punën që bëhet, për sfidat dhe për nevojat për plotësim-dryshim të legjislacionit.





FORUMI I PRESPËS PËR DIALOG KA VAZHDUAR PUNIMET EDHE TË PREMTEN

Kosova dhe Shqipëria të zhgënjyera me qasjen e BE-së

Kosova dhe Shqipëria janë ankuar në qasjen e Bashkimit Evropian ndaj këtyre dy vendeve dhe Ballkanit Perëndimor në përgjithësi. Në ditën e dytë të konferencës ndërkombëtare “Prespa Forum”, kryeministri Albin Kurti ka vlerësuar se Kosova është e zhgënjyer me BE-në për mosliberalizim të vizave dhe për moshapje të negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ndaj BE-së ankesa ka pasur edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe kryeministrat e tjerë të vendeve të rajonit që kanë marrë pjesë në këtë forum. Sipas tyre, pavarësisht prej zhgënjimit, BE-ja mbetet alternativë e vetme për rajonin

ka theksuar se BE-ja po tregohet jounike dhe e ngadaltë në procesin e integritimit në Ballkanin Perëndimor. “Republika e Kosovës e ndan zhgënjimin me vendimin e BE-së për moshapjen e negociatave me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut. Si vend që na është mohuar liberalizimi i vizave, e kuptojmë zhgënjimin tuaj. BE-ja është e ngadaltë, i mungon uniteti por, megjithatë, është shpresa jonë më e mirë dhe alternativa e vetme që e kemi. Ne i takojmë këtij rajoni. Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës dhe jemi shtete fqinje të shteteve të BE-së”, ka thënë Kurti.

Ai ka vlerësuar se vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të punojnë që të bëhen anëtarë të BE-së. Sipas Kurtit, kjo mund arrihet vetëm nëse vendet e Ballkanit e pranojnë të vërtetën historike dhe realitetin. “Në vend se të vazhdojmë të ndihemi të frustruar me vendimet e BE-së, duhet ta pyesim veten se çfarë

duhet të bëjmë ne për të arritur aty. Nëse shohim brenda nesh, shohim se kemi shumë probleme. Ekziston lufta mes pushtete autoritare dhe kundër monopoleve kriminale dhe kundër thyerjes së shtetit të së drejtës, mospranimi i të vërtetës historike dhe aktrimi se mund të ndërtojmë shoqëri demokratike në mes të kombeve tona vetëm duke mohuar se çfarë ka ndodhur dhe duke u munduar që ta ndryshojmë realitetin”, ka deklaruar Kurti.

Në Forumin e Prespës edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kritikuar BE-në. Ai ka thënë se BE-ja nuk mund t’u tregojë këtyre vendeve se çfarë të bëjnë. “Të falënderojmë Zotin që nga njëra anë Evropa nuk mund të na tregojë se çfarë të bëjmë në këtë rajon. Nga ana tjetër, ne mund të tregojmë se mund të bëhemi. Jemi mjaftueshëm të mëdhenj. Pse të presim të bëhemi pjesë e BE-së, ku mund të bëjmë vetë tregti pa barriera? U thirrëm nga Papa e BE-së,

Merkel dhe u gjetëm të gjithë në një tryezë. Kjo ishte një kthesë, që rezultoi në çështje dhe zhvillime të reja dhe, po ashtu, vendosi pengesë para burokracive të Brukselit. Por, nuk është punë e tyre që t’i zgjidhin problemet tona. Ne bëjmë diçka të shkëlqyer, u mblodhëm. Na duhet shtyrje. Ata janë më të frustruar prej nesh. Nuk do të lusim, nuk do të themi jemi djem të mirë, jemi çuna të mirë”, ka thënë Rama.

Liderët e Ballkanit Perëndimor kërkojnë bashkëpunim shtesë me ShBA-në dhe BE-në

Në këtë samit liderët e Ballkanit Perëndimor kanë kërkuar bashkëpunim shtesë me ShBA-në dhe BE-në. Sipas tyre, rikthimi i një lidhje dhe bashkëpunimi më të fortë në mes të BE-së dhe ShBA-së do të ndihmonte rajonin në rrugën integruese. “Ballkani Perëndimor është Evropë. Sa më të forta dhe stabile janë lidhjet

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, janë ankuar në qasjen e Bashkimit Evropian për këto dy vende dhe Ballkanin Perëndimor. Në ditën e dytë të konferencës

ndërkombëtare “Prespa Forum”, e cila po mbahet në Maqedoninë e Veriut, ata kanë bërë me dije se BE-ja në mënyrë të padrejtë po ia mohon Kosovës liberalizimin e vizave, kurse Shqipërisë dhe Maqedonisë hapjen e negociatave për anëtarësim në BE.

Kryeministri Albin Kurti, i cili ishte i pranishëm në këtë forum,



Sveçla viziton pikat kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar dhe pikën e kalimit kufitar në Vërmicë

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, i shoqëruar nga zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Liza Gashi dhe zëvendës drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, ka vizituar pikën kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe në pikën e kalimit kufitar në Vërmicë.

Qëllimi i këtyre vizitave ishte për të parë për së afërmi punën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen punonjësit e këtyre pikave, marrë parasysh faktin e shtimit të fluksit me ardhjen e

bashkatdhetarëve. Data 1 korrik edhe simbolikisht shënon hapjen e sezonit veror, kohë kjo kur edhe pritet ardhja e mërgatës sonë në Kosovë. Prandaj, në këtë datë edhe Policia e Kosovës dhe Policia e Shqipërisë kanë filluar patrullimet e përbashkëta në disa akse rrugore në Shqipëri, për të garantuar kështu siguri maksimale për qytetarët tanë të cilët do ta vizitojnë bregdetin shqiptar.

Gjatë kësaj vizite ministri Sveçla ka theksuar se ai tashmë ka nënshkruar marrëveshjen për krijimin e lehtësirave për hyrje

të bashkatdhetarëve në territorin e Republikës së Kosovës përmes së cilës MPB-ja merr përsipër pagesën e plotë të primit të sigurimit kufitar për ata që do të vijnë në Kosovë përgjatë vitit 2021. Ai ka theksuar edhe rëndësinë e respektimit të shenjave në trafik, me qëllim të parandalimit të aksidenteve në komunikacion. Nga dje, policia ka filluar edhe shpërndarjen e fletushkave me qëllim të sensibilizimit për të gjithë vozitësit. "Aksidentet në trafik kanë ndjeshmëri të lartë emocionale pasi që të gjithë ne dhe familjarët tanë mund të

përfshihemi në aksidente me fatalitet. Prandaj, lus të gjithë qytetarët t'i ngasin automjetet me kujdes të shtuar dhe t'i respektojnë rregullat në komunikacion", ka thënë ministri Sveçla.

Gjatë vizitës në pikën e kalimit kufitar në Vërmicë ministri Sveçla u njoftua edhe për numrin e qytetarëve të cilët kanë kaluar nëpër këtë pikë gjatë këtij viti, ku u konstatua se, krahasuar me vitet paraprake, duke përfshirë vitin 2020, numri i personave që kanë kaluar nëpër këtë pikë është rritur për 400 mijë.



transatlantike, aq më i fortë, stabil dhe me prosperitet është Ballkani Perëndimor. Një angazhim i përbashkët mes ShBA-së dhe Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor është esencial. BE-ja duhet ta gjejë përsëri veten dhe të kthehet në rrënjët e veta", ka thënë kryeministri maqedonas Zoran Zaev.

Kurse kryeministri i Kosovës Albin Kurti, ka deklaruar se ideja e një mini-Shengeni nuk është në shërbim të qytetarëve të rajonit. "Një pjesë e madhe e përgjegjësisë qëndron te BE-ja, por edhe ne duhet t'i kryejmë detyrat e shtëpisë. Edhe ideja e Novi Sadit për 'Mini-Schengenin', një iniciativë që nuk ka vizion për rajonin, dhe që Republika e Kosovës e kundërshton ashpër, si e tillë, duhet të flakët tutje. Pakënaqësia me BE-në nuk duhet të instrumentalizohet nga vendet që nuk e duan NATO-n dhe që e favorizojnë Rusinë", është shprehur Kurti.

Ai ka treguar se cilat iniciativa rajonale i përkrah. "Ne mirëpresim iniciativat që bazohen në barazi, reciprocitet dhe njohje të realitetit dhe të vërtetës. Duke u pajtuar se na duhet të bëjmë shumë punë dhe duke e parë që korniza e tanishme e bashkëpunimit rajonal nuk është e mjaftueshme për të na përgatitur neve për

qasje në BE, ne kemi propozuar një kornizë të re bashkëpunimi SEFTA, sipas modelit EFTA EEA. Me procesin e Berlinit që i afrohet fundit, SEFTA (Zona e Tregut të Lirë për Evropën Jug-Lindore) është mënyra e drejtë për të ecur përpara sepse rikthen angazhimin e rajonit për reforma", ka thënë ai.

Edhe kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka treguar ankesat ndaj BE-së. "Serbia, vazhdimisht

kujtohet nga vendet anëtare për të drejtat nacionale të pakicave. Kjo është fantastike sepse, në pikëpamjen time, të drejtat njerëzore të pakicave janë disa nga vlerat kyçe evropiane. Por për respektimin e të drejtave të pakicave, Serbia është ndër vendet liderë në Evropë. Por ka vende anëtare që nuk i njohin disa nga pakicat që janë në vendin tonë dhe thonë deri sa ta zgjidhni këtë problem nuk mund

të vazhdoni më tej në rrugën eurointegruese dhe filloni të pyesni veten se cila është gjëja e drejtë?", ka deklaruar Bërnabiq. Në ditën e parë të forumit, edhe zëvendësi i ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, kishte shprehur dëshpërimin e tij që Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria nuk arritën të nisnin negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Palmer kishte shprehur zhgënjimin edhe

për mosliberalizimin e vizave për Kosovën. "Është jetike që BE-ja ta mbështesë rajonin dhe ta miratojë liberalizimin e vizave për Kosovën. Jemi të zhgënjyer nga vendimi për të mos nisur negociatat, sepse këto shtyrje kanë penguar përparimin e synimeve tona në rajon, jo vetëm normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë por, më shumë se kaq", ka deklaruar Palmer.

Podujeva binjakëzohet me Linzin e Austrisë

PODUJEVË, 2 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi dhe kryetari i komunës së Linzit, Klaus Luger, kanë nënshkruar marrëveshjen e binjakëzimit në mes të këtyre dy qyteteve. Në një ceremoni solemne të organizuar në Linz të Austrisë, kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi dhe kryetari i komunës së Linzit, Klaus Luger, kanë nënshkruar marrëveshjen e binjakëzimit. Me këtë rast, kryetari Bulliçi ka thënë se ky është një hap shumë i rëndësishëm për dy qytetet tona për të ngritur ura të reja të miqësisë dhe të bashkëpunimit. "Ky është një hap shumë i rëndësishëm për qytetet tona, për të ngritur ura të reja të miqësisë dhe të bashkëpunimit në shumë fusha në interes të zhvillimit. Për mua, si kryetar i komunës së Podujevës, është nder i veçantë të nënshkruaj marrëveshjen e binjakëzimit

me një komunë të njohur dhe shumë të zhvilluar industrialisht siç është Linzi", ka thënë Bulliçi. Bulliçi ka thënë se bashkëpunimet tona do të jenë kryesisht në fushën e ekonomisë, arsimit, shëndetësisë, politikave sociale dhe kulturës. Ndërsa pas ceremonisë së nënshkrimit, të dy kryetarët u zotuan të punojmë në mënyrë aktive për përafrimin e dy qyteteve dhe thellimin e miqësisë në të mirë të qytetarëve, veçanërisht të rinjve.



Në përfundim të vitit shkollor, drejtoresha e Arsimit në Prishtinë shpërndan mirënjohje për nxënësit

Prishtinë, 2 korrik (ER) - Me rastin e përfundimit të vitit shkollor, drejtoresha e Arsimit në Prishtinë, Shpresa Shala, ka vizituar të premtën Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Dardania", me ç'rast u ka uruar suksese nxënësve dhe i ka përgëzuar mësimdhënësit për

punën e palodhshme përgjatë kësaj periudhe të vështirë shkaku i pandemisë. Ajo ka thënë se Drejtoria e Arsimit ka bërë gjithçka që ka qenë e mundur që të sigurojë mbarëvajtjen e procesit mësimor, së bashku me të gjithë partnerët lokalë dhe

ndërkombëtarë. Gjatë vizitës së saj, drejtoresha Shala ka shpërndarë edhe disa mirënjohje për nxënësit e klasave të pesta për përfundimin e një viti të suksesshëm shkollor. Ajo të gjithë nxënësve u ka uruar pushime të këndshme dhe suksese në vitet e ardhshme.

Këshilli protestues i ndërmarrjes 'Trepça' kërkon realizimin e kërkesave



MITROVICË, 2 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga nënkryetari Faruk Mujka, kanë pritur në takim përfaqësuesit nga këshilli protestues i ndërmarrjes publike "Trepça", në krye me Arsim Musa, gjatë kohës kur po mbahej protesta e tyre pranë objektit të komunës. Në këtë takim është diskutuar për pakënaqësitë e protestuesve lidhur me procesin e fundit të punësimit në kombinatin "Trepça", të cilët përmes protestave ende vazhdojnë të kërkojnë sistemimin e tyre në punë. Me këtë rast, këshilli protestues ka kërkuar nga kryetari Bahtiri mbështetje për

adresimin e kërkesës së tyre në instancat më të larta të Qeverisë së Kosovës pasi, siç thonë ata, nuk kanë marrë ende asnjë përgjigje në lidhje me çështjen e punësimit të tyre dhe u bënë disa muaj prej kur ata janë duke protestuar. Ndërsa kryetari Bahtiri u ka thënë atyre se edhe në takimet paraprake që i ka pasur me ta, ka ritheksuar se kjo çështje nuk është në kompetencën e tij si kryetar komune, mirëpo ka qenë i angazhuar dhe në kontakt me personat kompetentë në Qeverinë e Kosovës dhe do të bëjë përpjekje maksimale që në ditët në vijim të marrë një përgjigje në lidhje me kërkesën e tyre.

Vaksinohen 8 928 gjilanas kundër Covidit

GJILAN, 2 KORRIK (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, në takimin e mbajtur të premtën, të udhëhequr nga nënkryetari i komunës, Arbër Ismajli, kanë bërë vlerësimin e gjendjes me pandeminë në këtë komunë, duke marrë parasysh edhe rritjen e numrit të qytetarëve, me ardhjen e mërgatës në shtëpitë dhe familjet e tyre, është kërkuar vigjilencë dhe kujdes i shtuar që të mos përhapet virusi.

Ismajli ka bërë me dije se deri tani janë dhënë gjithsej 8 928 vaksina kundër Covid-19, derisa ka konfirmuar se procesi i vaksinimit po shkon

mirë dhe tashmë është zgjeruar edhe vaksinimi, që duhet të bëhet përmes terminëve online për të caktuar datën e vaksinimit. Nënkryetari Ismajli ka potencuar se të gjithë ata që janë testuar dhe në rezultat e tyre konfirmohet se janë të infektuar me virusin Covid-19, duhet të qëndrojnë në vetizolim, në të kundërtën, nëse hasen se e thejnë rregullin e vetizolimit, dënohen nga Policia e Kosovës në bazë të ligjit me dënime mandatore. Drejtoresha e Qendrës Kryesore e Mjekësisë Familjare, Arbenita Hajdari, ka thënë se vaksinimi deri sot ka shkruar shumë mirë.



KUVENDI I KOSOVËS KA SHËNUAR PËRVJETORIN E 31-TË TË MIRATIMIT TË DEKLARATËS
KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT TË VITIT 1990

Zbulohet pllaka përkujtimore për Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut



Amerikës”, ka deklaruar Osmani.

Bashkimi i shqiptarëve të Kosovës u pa nga ish-kryetari i Kuvendit, Iljaz Ramajli, si një ndër faktorët kyçë që mundësuuan veprimin e delegatëve të atëhershëm. “Shpalljes së deklaratës i kishte paraprirë unifikimi i plotë i faktorit shqiptar në Kosovë... Shfrytëzoj rastin t'i përkujtoj edhe 39 delegatë që tashmë nuk janë gjallë”, ka thënë ai.

Pas fjalimeve, në Kuvend u transmetua një dokumentar për autorin e Deklaratës Kushtetuese, Gazmend Zajmi. Pastaj kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, bashkë me presidenten Vjosa Osmani dhe ish-deputetin Muharrem Shabani, zbuluan në hyrje të ndërtesës së Kuvendit pllakën me anë të së cilës përkujtohet 31-vjetori i miratimit të Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut të vitit 1990. Pllaka është vendosur pikërisht në vendin ku është lexuar Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990.

Kryetari Konjufca ka thënë se me këtë pllakë nderojnë të gjithë ish-deputetët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës të cilët ishin nënshkrues të Deklaratës së 2 Korrikut. “Me deklaratën e 2 korrikut të vitit 1990 ju e keni bërë Kosovën të barabartë me republikat e tjera në atë kohë. Faktikisht ju e keni shpallur pavarësinë e këtij Kuvendi”, ka thënë Konjufca.

Delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës më 2 korrik të vitit 1990 miratuan publikisht (para Kuvendit të Kosovës) Deklaratën Kushtetuese, me të cilën Kosova u shpall njësi e veçantë në kuadër të Federatës së atëhershme Jugosllave. Dy muaj pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese, më 7 shtator të vitit 1990, në Kaçanik u miratua Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e njohur si Kushtetuta e Kaçanikut.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, bashkë me presidenten Vjosa Osmani dhe ish-deputetin Muharrem Shabani, kanë zbuluar të premten në hyrje të ndërtesës së Kuvendit pllakën me anë të së cilës përkujtohet 31-vjetori i miratimit të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990. Pllaka është vendosur pikërisht në vendin ku është lexuar Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Tridhjetë e një vjet pasi kishte udhëhequr seancën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 1990, Iljaz Ramajli u ul afër presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për ta përcjellë seancën solemne të Kuvendit të Kosovës.

Deputetët u mblodhën të premten në Kuvend, së bashku me shumë ish-delegatë të Kuvendit të

Kosovës të vitit 1990, të cilët kishin bërë shpalljen e Deklaratës Kushtetuese, më 2 korrik të vitit 1990.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, e cilësoi veprimin e delegatëve të asaj kohe një ndër më të guximshmit në histori. “Ky ishte akti më i rëndësishëm e më i guximshëm i përfaqësuesve të popullit qysh pas Konferencës së Bujanit. Pikërisht para dyerve të Kuvendit të sotëm, delegatët e atëhershëm e votuan Deklaratën e 2

korrikut, të cilën e lexoi Muharrem Shabani”, ka thënë Konjufca. Sipas Konjufcës, delegatët e 2 korrikut ishin “mishëruesit e vërtetë të vullnetit kolektiv të popullit tonë për liri dhe të drejtën e vetëvendosjes”.

Presidentja Vjosa Osmani kujtoi, po ashtu, guximin dhe vullnetin e 114 delegatëve për ta bërë shpalljen e pavarësisë në atë kohë, kur Kosova gjendej nën okupimin serb. “Ne kujtojmë jo vetëm një veprim të përgjegjshëm, por

edhe një përcaktim të vendosur për një të drejtë historike, të mohuar për dekada të tëra”, ka thënë Osmani. Ajo ka përmendur edhe faktin se Kosova sot është e pavarur dhe ka thënë se vullneti i atëhershëm u realizua. “Sot Kosova është vend i lirë dhe sovran në kufijtë e 17 shkurtit dhe i tillë do të qëndrojë përgjithmonë, i orientuar qartë drejt integritimit euroatlantik dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të

Dy viktima dhe 17 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Në Kosovë të premten janë shënuar edhe dy të vdekur nga Covid-19. Viktimat janë nga komuna Lipjani dhe Gjakova. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka njoftuar se janë regjistruar edhe 17 raste të reja me Covid, bazuar

në 1 241 mostra të testuara. Sipas njoftimit, nga Covid-19 janë shënuar edhe tetë pacientë, ndërsa raste aktive janë 172. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 107 785 pacientë me këtë virus. Prej

këtyre, 2 260 kanë vdekur, ndërsa 105 353 janë shëruar. Në sajë të raportit të punës për datën 2 korrik 2021, 87 pacientë janë duke u trajtuar në klinikat Covid të QKUK-së dhe në spitalet e përgjithshme. 31 janë të konfirmuar pozitivë, 3 janë në gjendje të rëndë dhe 63

janë me oksigjeno-terapi. Deri të premten, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë, janë dhënë 196 829 doza të vaksinës, ndërsa 47 141 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë kundër Covid-19. Procesi i vaksinimit në Kosovë ka nisur në fund të muajit mars.





Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Pse po sulmohet turizmi në Shqipëri nga vetë shqiptarët?

Fushatë e orkestruar për ta dëmtuar turizmin: Krimi i rëndë në Velipojë, që për pasojë pati katër (4) të vrarë dhe dy të plagosur, vënia e flakës mbi 60 shezlongëve në Drimade (Dhërmi), dëmtimi i shezlongëve në Ksamil, faturat shumë të fryra, përsëritja e rastit të ngjashëm me atë të Koço Kokëdhimës dhe “antikosovarizmi” në Durrës, janë vetëm disa shembuj që e paraqesin në mënyrë kompromituese gjendjen dhe sigurinë e mysafirëve në plazhet e bukura të detit Adriatik dhe detit Jon në Shqipëri. Për dallim nga kjo zyrtësi përshkruese e gjendjes së turizmit në Shqipëri e që e bëjnë, me qëllim të caktuar kryesisht gazetarë të caktuar dhe personalitete nga Kosova dhe nga Shqipëria, shumë agjenci botërore rekomandojnë Shqipërinë si vend ideal për pushime duke e konsideruar si perlë apo xhevahir turistik. Rasti i Velipojës është jashtëzakonisht i rëndë dhe me përfundim tragjik të cilin keqdashësit e përdorin për të bërë një propagandë të ndyrë kundër turizmit dhe vetë Shqipërisë dhe për t’ua bërë një

shërbim prej djalli vendeve apo agjencive të tjera që Shqipërinë e shohin si konkurrenca në këtë fushë. Media të papërgjegjshme dhe tendencioze filluan të bëjnë “hulumtime” dhe anketa me pushuesit dhe, për çudi, hapësirë fitonin kryesisht ata që bënin thirrje të mos shkohet në Shqipëri, por të shkohet në Mal të Zi apo vende të tjera. Realisht, të gjithë ata që e kanë përcjellë zhvillimin e përgjithshëm në Shqipëri e në këtë kontekst zhvillimin e turizmit në veçanti, që nga vitet ’90, lehtësisht mund ta konstatojnë se Shqipëria është zhvilluar më shpejt dhe më shumë se çdo shtet në Ballkan. Pas rënies së komunizmit në Shqipëri u krijuan mundësitë që të vizitohet ky vend i amshuar për të gjithë shqiptarët e që për shqiptarët e Kosovës ishte, thjesht, një ëndërr, hiç ata që dërgoheshin atje nga UDB-a jugosllave, idealizmi i projektuar në mendje, zemër dhe ndërdije u zëvendësua me një zhgënjëm të madh dhe dëshpërues, e që nuk ishim në gjendje as ta besonim e as ta pranonim! Kur dola nga burgu - Llogori i Stara Gradishkës në vitin 1990, me

një pasaportë të lëshuar në Kroaci, por që e kishte ngjyrën e kuqe kisha mundësi të shkoja në Shqipëri përmes Maqedonisë e që e shfrytëzoja këtë mundësi duke e vizituar Shqipërinë disa herë. Para meje në Shqipëri pati shkuar një shok imi i ngushtë, Hajrullah Uka i cili, me një takt të balancuar bënte përpjekje të më përgatiste për atë që do ta shihja duke e ditur dashurinë e madhe që e kisha për Shqipërinë. Në fakt, sa isha në llogoret e ish-Jugosllavisë, për 8 vjet e 6 muaj burg, e dëgjoja Radio Tiranën (ilegalisht) dhe, duke e kërkuar të vërtetën për gjendjen ekonomike dhe politike, midis lajmeve që ishin krejtësisht të orkestruara, nuk prisja që Shqipëria të ishte si Zvicra e as si Norvegjia, por se nuk kisha paramenduar as në imagjinatën më të shëmtuar se gjendja ishte ashtu siç e pashë në fundvitin 1990. Edhe ashtu nuk njihesha aspak si përkrahës i Enver Hoxhës gjë që nganjëherë ndizte shkëndija me shokë gjatë vuajtjes së dënimit, por që kaloheshin shpejt për faktin se të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë që vuanin në llogoret e ish-

Jugosllavisë ishin patriotë të vërtetë, të pabindur ndaj regjimit jugosllav, të vendosur në mbrojtje të qëndrimeve të tyre politike dhe edhe më të vendosur në vazhdimin e luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar. Të burgosurit politikë shqiptarë në llogoret e ish-Jugosllavisë nuk pranonin asnjë përfitim, lirim të parakohshëm apo falje e që do të mbështetej në kërkesat e tyre për faktin se nuk bënë asnjë kërkesë drejtuar udhëheqjes jugosllave me të cilën do të përfitonin. Vërtet ishin të qëndrueshëm, të mahnitshëm dhe të vendosur ta përballojnë çdo sakrificë! Unë mësoja prej tyre dhe e dija se të gjithë ishim kombëtarë, por se dashuria ndaj Enver Hoxhës, në të vërtetë ishte dashuria ndaj Shqipërisë dhe se ashtu do të përkrahnim çdokënd që do të ishte në Shqipëri, si udhëheqës në ato kohë. Idealizmi na mbante, edhe të fortë, edhe të bashkuar. Ishte dhe shumë mirë që nuk e dinim gjendjen reale në Shqipëri sepse edhe mund të ligështohemi pakëz. Kush ka kaluar shumë vite bashkë me Bacën Adem Demaçi, Fehmi Lladrovcin,

Remzi Ademajn, Rexhep Malën dhe Skender Kastratin, dr. Hafir Shalën dhe dr. Haki Gashin dhe të burgosur të tjerë, këtë kohë nuk mund dhe nuk duhet ta llogaritën si vuajtje, por si kohë e vetëdijesimit dhe të përndritjes, si shkollë, fakultet dhe akademi e atdhedashurisë dhe sakrificës. Këtë e dëshmuuan pasi dolën nga burgu duke u flijuar për lirinë edhe të atyre që na arrestuan apo që në emër të një rezistence paqësore që bëhej për të siguruar prapënicat e tyre, e dëmtuan shumë luftën çlirimtare e udhëhequr nga e lavdishmja Ushtri Çlirimtare e Kosovës, në me krye komandantin legjendar, të pavdekshmin dhe të amshueshmin Adem Jashari, si dhe abetaren, kuptimin dhe përmbajtjen e lirisë dhe bashkimit kombëtar, kolosin që në shqiptari lind një në 5000 vjet, të papërsëritshmin dhe vetëmohuesin bibliq, bacën Adem Demaçi! Në anën tjetër, nuk e besoj se ka vend në botë ku horrat dhe sabotuesit e luftës çlirimtare të kenë përfituar më shumë politikisht dhe ekonomikisht se në Kosovë. Kjo gjendje vazhdon edhe sot dhe zgjatjet e tyre biologjike dhe

gjenetike bëjnë shtatë palë qejfe në Kosovë duke sulmuar, fyer luftën çlirimtare dhe duke denoncuar dhe përgatitur dosje kundër luftëtarëve dhe udhëheqësve të luftës çlirimtare, tash si kolonë e pestë, prandaj edhe mbahen në burgun e Hagës ata që i prinë dhe e fituan luftën. Ky është mallkimi që i përcjell shqiptarët ndër shekuj, ata që sakrifikohen e pësojnë, kurse puthadorët dhe horrat përparojnë!

Shqipëria e viteve '90: Shqipëria e viteve '90, përveç tokës dhe ajrit, nuk kishte asgjë që do t'i përmbushte edhe minimalisht nevojat e qytetarëve. Nuk kishte shtëpi, nuk kishte drita e as ujë, rugët ishin si në Kandahar, kurse kanalizimi ishte ai që kishte mbijetuar kohët nga romakët dhe ilirët. Si mjete transporti, madje edhe në Tiranë përdoreshin kamionë dhe autobusë të demoluara dhe pa xhama e në jo pak raste edhe gomarët. Biçikleta ishte mjeti kryesor dhe ishte luks për shumicën e qytetarëve të Shqipërisë. Shitoret ishin keq të furnizuara dhe mungonin artikujt elementarë. Edhe për të blerë bukë bëheshin radhë të gjata. Mbajë mend se shumë shqiptarë, në mundësinë e parë që e kishin, hynin në oborrin e ambasadave të huaja, si mundësi e vetme për t'u larguar nga Shqipëria në kërkim të një jete më të mirë. Gratë punonin punët më të rënda, kurse burrat pinin tërë ditën një alkool të keq dhe kur i pyesja pse nuk po punojnë, përgjigja e tyre ishte: "Kemi vuajtur shumë dhe tani ka ardhur demokracia...". Rruga Morinë - Kukës ishte tmerr, kurse ajo Elbasan - Tiranë përmes Qafë-Kërrabës ishte ferr. Po të largohesh 100 metra nga qendra e Tiranës e që ishte ndërtuar nga italianët, kaloje në një botë tjetër me rrugë të shkatërruara dhe të mbuluara me pluhur, baltë dhe mbeturina. Po të kishe nevojë ta bëje një thirrje telefonike, duhej

të prisje disa orë ose ta korruptoje punëtorin e postës. Kur e fitova të drejtën ta bëjë një thirrje telefonike, punëtorja e sportelit m'u drejtua me fjalët: "Kosovar, rri para kabinës numër tre se ajo do të lirohet pas një ore...". Kishte pasiguri fizike për shkak se kishte pasiguri politike.

"Dallëndyshet" e para nga Kosova e që unë i quaj korba e që shkuan në Shqipëri ishin të dërguarit e UDB-së dhe horret e të gjitha llojeve të cilët, me porosi nga UDB-a, nuk lanë të zezë pa bërë në Shqipëri duke e keqpërdorur gjendjen e rëndë ekonomike dhe brishtësinë e situatës politike.

Unë me Hajrullah Ukën e vendosëm në Durrës, te Bashkimi që na priti shumë mirë gjatë kohës sa qëndruam aty, për një kompensim thuaja modest. Na dërgoi në Kukës, Elbasan, Librazhd, Krujë dhe Tiranë. Durrësi, si qyteti kryesor turistik, ishte i mbushur me lypsarë, anije dhe udhëtarë që lëviznin drejt Italisë. Nuk kishte fare infrastrukturë në plazh e që vërshohej nga ujëra të zeza. E kundërta e kushteve për një turizëm minimal e lëre më konkurrues. Shumë rrallë dëgjohej muzika në gjuhën shqipe, kurse mbizotëronte ajo nga Serbia. CD dhe kasetat që shiteshin në tregje ishin kryesisht nga tregu jugosllav. Për një patriot idealist ishte fundi i botës, hyrje në kataklizmë. Skemat piramidale kishin bërë kërde, ndërsa Sudja dhe Xhaferri, pasi i kishin plaçkitur shqiptarët përmes këtyre skemave, ishin zhdukur. Politikën e bënin politikanët që për këshilltarë dhe mbrojtës kishin bandat famëkëqija shqiptare që, brenda një afati të shkurtër kohor, ia futën flakën Shqipërisë tri herë duke e lënë, pa polici dhe pa ushtri!

Mirëpo, Shqipëria dhe shqiptarët dëshmuar një shkathtësi të jashtëzakonshme, jo vetëm për të mbijetuar, por

për t'u zhvilluar, më shumë dhe më shpejt se çdo vend në Ballkan. Shqipëria, nga një vend transit për turistë, u shndërrua në një vend destinacioni për turistë, jo vetëm shqiptarë, por nga e tërë bota. Krahasojini plazhin e Velipojës dhe të Shëngjinit si edhe vetë qytetet brenda një harku kohor prej 30 vjetësh?! Ndryshimet janë të paimagjueshme dhe të pabesueshme. Shikojini sot Tiranën, Durrësin, Elbasanin, Fierin, Beratin, Korçën, Vlorën dhe Sarandën. Sikur të jemi në një botë tjetër. Shëtitorja transshqiptare bregdetare Velipojë - Ksamil po jetësohet në projektin Lungo mare. Tmerri dhe ferri i dhiareve Morinë - Kukës -Tiranë dhe Elbasan - Tiranë janë shndërruar në rapsodi rrugore që e shkurton shumë rrugëtimin dhe e lehtëson drejtimin e makinave. Nga Tirana - Durrës - Fier - Vlorë dhe deri në Gjirokastrë përkatësisht deri te Qafa e Muzines thuaja është autostradë. Sikur që është kënaqësi të shkoni në Pogradec përmes autoudhës, thuaja ngjitur me liqenin për të vazhduar pastaj për në Korçë. Në asnjë vend në Ballkan nuk keni të ndërtuar aq shpejt dhe aq mirë një rrjet komunikimi rrugor. Edhe Kosova është mirë në këtë drejtim. Në Shqipëri është përmirësuar dukshëm furnizimi me ujë dhe rrymë sikur që është ndërtuar rrjeti i kanalizimit. Edhe furnizimi me artikuj ushqimorë është thuaja i njëjtë me të gjitha vendet evropiane sikur që kapaciteti akomodues për turistë është mijërafishuar. Keni mundësinë të zgjidhni midis ofertave që përputhen me mundësitë materiale, nga ato modeste e deri tek ata që ndihen si aristokratë apo snobë.

Gjatë zhvillimit të shpejtë të Shqipërisë, në përgjithësi, dhe turizmit në veçanti, janë bërë

gabime dhe lëshime në planifikimin e nevojave dhe të mundësive. Si çdo qytet bregdetar në botë, edhe qytetet e Shqipërisë po përballen me mungesën e vendeve për parkim të automjeteve, mirëmbajtje të pastërtisë, mirëmbajtje të plazheve, instalim të dusheve në plazh dhe të ujit të pijshëm e sidomos kontroll kundër ngritjes së çmimeve e që janë në shpërputhje me kushtet dhe shërbimet e ofruara. Pandemia ka shkatërruar infrastrukturën turistike në Shqipëri dhe vetëm injeksioni i shqiptarëve nga Kosova gjatë fundjavës ka ndikuar që turizmi të mbijetojë në kushte ekstreme.

Tash është përhapur një luftë speciale kundër turizmit në Shqipëri nga vetë shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë, përkatësisht nga ata që kurrë nuk e kanë dashur Shqipërinë dhe shqiptarët. Të përpiqesh të gesh qime në ve në turizmin shqiptar duke regjistruar edhe pordhët e pulave dhe ta përdorësh si pretekst për të bërë thirrje të mos shkohet në Shqipëri, por në Mal të Zi, nuk është vetëm mungesë e korrektësisë, por se kjo e ka qëllimin e caktuar dhe të porositur. Ajo çka ndodhë në Shqipëri është e papërfillshme me atë që ndodh edhe në qendrat më të njohura turistike në botë si në Meksiko, Brazil, Kroaci, Spanjë, Francë, Itali, Greqi, Egjipt, Maroko, Tunizi, Filipine dhe qendra të tjera ekzotike. Të gjithë mund të gabojmë në vlerësime, p. sh., unë mendoj se të gjithë ata që duan të shkojnë në Ulqin, Budva apo Herceg novi, janë nostalgjikë për ish-Jugosllavinë, por se nuk bëj thirrje të mos shkohet në ato vende.

Gjatë luftës në Kosovë shqiptarët e Shqipërisë hapën dyert e shtëpive dhe banesave të tyre për shqiptarët e përzënë nga Kosova duke ua ofruar çdo gjë që kishin dhe duke e lënë veten keq vetëm që të krijojnë kushte më

të mira për kosovarët. U krijuan miqësi personale dhe familjare që, nga viti në vit, vetëm sa u forcuan. Në vitin 2000 shkova me familje për pushime në Sarandë dhe nga ajo kohë nuk ndodh që brenda vitit të mos shkoj në Sarandë, Tiranë, Fier apo Ksamil. Tash në Sarandë shkojmë te Arben dhe Mira Hito sikur në shtëpinë tonë dhe sikur të ishim një familje sikur që edhe ata ndihen njëjtë kur janë në Prishtinë. Në Ksamil e kemi gjithmonë derën e hapur tek Auguri - Guri dhe familja e tij sikur që në Fier i kemi miqtë e shpirtit, me një miqësi thuaja 20 vjeçe, te Valbona Llambrollari dhe Ermelinda Qato. Prandaj edhe nuk kërkojmë alternativë tjetër. Sigurisht se edhe qytetarët e tjerë nga Kosova kanë miq sikur ne dhe e ruajnë dhe forcojnë miqësinë e munguar dhe të penguar që nga viti 1945 e deri më 1990.

E kemi vetëm një Shqipëri. Shqipëria duhet të bëhet dhe jo të zhbëhet. Turizmi shqiptar duhet të ndihmohet e jo të pengohet gjithnjë duke respektuar vullnetin e përcaktimit se çdokush ka të drejtë të shkojë në pushime ku të dojë, pa përdorur goditje të ulëta kundër njerit apo tjetrit vend. Turizmi shqiptar ka shkuar përpara me hapa të mëdhenj, me një dinamikë të përshpejtuar. Me kohë po integrohet në rrjedhat e turizmit elitë botëror. Kontributi i shqiptarëve të Kosovës dhe shqiptarëve anekënd botës është i madh, i jashtëzakonshëm. Në fund të fundit, si shqiptarë nuk po bëjmë asgjë që nuk na takon, po i ndihmojmë dhe po e forcojmë shtetin tonë, vendin tonë, mbamendjen tonë historike, ndërgjegjen tonë, qenien tonë, djepin tonë dhe vetë ekzistencën tonë. Nuk ka vend si Shqipëria. Ajo është dashuria jonë e parë dhe e vetme, e përjetshme, deri në amshim. Është trajektorja e rrugëtimin tonë midis dy pikave: lindjes dhe vdekjes!



Murati në takimet vjetore të BERZh-it kërkon qasje proaktive ndaj sektorit privat

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka marrë pjesë në takimet vjetore të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), në cilësinë e guvernatorit të Republikës së Kosovës në këtë bankë. Gjatë seancës plenare, Murati së bashku me guvernatorët e shteteve të tjera anëtare të bankës, vlerësuan lart angazhimin e BERZh-it në adresimin e krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 përmes



instrumenteve fleksibile dhe efektive të investimit. Më tutje, në deklaratën e tij, Murati ka inkurajuar menaxhmentin e bankës që të ketë qasje proaktive në angazhime si të sektorit privat ashtu edhe atë publik, në mënyrë që të sigurohet rimëkëmbje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme. Ministri, po ashtu, ka theksuar edhe rëndësinë e adresimit të sfidave të ngrohjes globale duke ndjekur ambicjet klimatike të BERZh-it, sado sfiduese që

mund të jenë karshi sfidave të tjera zhvillimore të vendit tonë. Duke e mbështetur bashkëpunimin e shkëlqyer të së kaluarës, ministri Murati ka përsëritur angazhimin e Kosovës për thellimin e bashkëpunimit për implementim të iniciativave për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. BERZh-i këtë vit feston 30-vjetorin e themelimit, ndërsa Republika e Kosovës është anëtarësuar në këtë institucion ndërkombëtar financiar që nga viti 2012.

Lansohen pullat postare “Nga trashëgimia, hedhja e gurit, luajtja me shkop etj”

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Posta e Kosovës ka lëshuar të premten në qarkullim emisionin e ri të pullave postare të titulluar: “Nga trashëgimia, hedhja e gurit, luajtja me shkop etj”. Përmes imazhit të këtyre dy pullave postare, Filatelia e Kosovës paraqet hedhjen e gurit, njëherë nga lojërat shumë të popullarizuara në trojet e Kosovës, me të cilat promovon nëpër botë trashëgiminë kulturore të Republikës së Kosovës. “Ruajtja e trashëgimisë kulturore vlerësohet si çështje që mbron identitetin e një populli dhe ofron mundësinë që këto vlera të barten edhe te gjeneratat e reja. Për ta kuptuar të sotmen, është e

domosdoshme të njihet e kaluara e një populli”, është thënë në njoftimin e Postës së Kosovës, duke shtuar se lojërat tona tradicionale zhvilloheshin kryesisht nëpër tubimeve dhe ahengje familjare. “Të rinjtë gjatë kryerjes së punëve, gjatë pushimeve të shkurtra, kanë luajtur lojëra të ndryshme. Në të gjitha lojërat tradicionale janë evidente elementet e folklorit dhe traditës. Për ta luajtur këtë lojë, lojtarët është dashur të jenë në moshë të rritur, të fuqishëm dhe të kenë kurajë, mbase vlerësohej fuqia, zotësia, si dhe teknika e një lojtari, vlera këto shumë të çmuara në të kaluarën tonë”, është thënë në njoftimin e Postës së Kosovës.



Caritas-i ofron përkrahje për fermerët



PRISHTINË, 2 KORRIK - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka pritur në takim përfaqësuesit e Caritasit zviceran në Kosovë në përbërje nga drejtori i Caritasit për Kosovë, Gerhard Schaumberger dhe menaxheri i projektit, Veton Rruka, me të cilët ka biseduar rreth zhvillimit të prodhimtarisë bujqësore. Me këtë rast, ministri Faton Peci ka falënderuar përfaqësuesit e Caritasit për mbështetjen e dhënë për sektorin e

bujqësisë në vend dhe u ka ofruar përkrahje për realizimin e projekteve të tjera që kanë të bëjnë me mbështetjen, zhvillimin dhe avancimin e sektorit të bujqësisë. Gjatë këtij takimi drejtori i Caritasit për Kosovë, Gerhard Schaumberger, ka paraqitur mundësitë për bashkëpunim në projektet e tyre që kanë për qëllim përkrahjen e fermerëve në zonat rurale dhe e ka njoftuar ministrin me format e bashkëpunimit të cilat ata janë të gatshëm t'i zhvillojnë për bujqësinë në Kosovë.

Iniciohet shkarkimi i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

PRISHTINË, 2 KORRIK (ER) - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë, me 6 vota për, një kundër dhe një abstenim ka iniciuar shkarkimin e bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Kërkesën për shkarkim e ka bërë deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Salih Zyba. Kundër shkarkimit të këtij bordi është shprehur deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Fadil Nura. Kurse deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës

(LDK), Besian Mustafa, ka abstenuar në votim, me arsyetimin se duhet të bëhet një analizë e secilit anëtarë veç e veç. Kryetarja e këtij komisioni, Fitore Pacolli, ka thënë se kur bordi ka raportuar nuk ka arritur të bëjë dallime se kush ka punuar mirë dhe kush jo.



DISKUTIMI I KRYETARIT TË UNIONIT TE BIZNESEVE SHQIPTARE-GJERMANE NË GJERMANI Z. NAZMI VIQA, MBAJTUR NË EMERALD NË PANELIN E DIPLOMACIA KOMERCIALE ME 2 KORRIK 2021

DIPLOMATI KOMERCIAL NË GJERMANI DUHET TË JETË EKSPERT I MIRË, QË PUNON SHUMË DHE QË I KONTAKTON BIZNESET



Moderatori i panelit Diplomacia Komerciale z. Artan Loxha, pyetje drejtuar Kryetarit të Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane në Gjermani z. Nazmi VIQA.

Z. Viqa, sa shpesh mbani kontakte me misionet diplomatike në këtë rast në Gjermani, për ndarjen e informatave të ndryshme sa i perket partneriteteve potenciale Kosovë dhe biznese gjermane? Cfarë sugjerime konkrete keni që informatat mbi mundësitë e tilla biznesore, në vend ku ju operoni, tu vihet në dispozicion misioneve diplomatike, të cilat mund të shërbejnë realisht si urë lidhëse në këtë lloj të analizimit të tregut?

Kryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane në Gjermani z. Nazmi VIQA:

Faleminderit për pyetje, unë shfrytëzoj rastin tu përshendes të gjithë biznesmenët këtu, sidomos bizneset që kanë ardhur nga diaspora, që kanë marrë një udhë nga vise të ndryshme të Europës edhe e di që të gjithë kanë ardhur me qef dhe kanë një vullnet të madh.

Këtë vullnet që e kemi ne të gjithë të vijmë në Kosovë, duhet ta shfrytëzojmë edhe qeveria e tashme, mos me thënë që të tjerët nuk e kanë bërë, premtime kemi pasur gjithmonë shumë, por besoj se nuk kemi mundur me ba shumë.

Unë kam knaqësi këtu sa herë që vij, edhe kontaktet që i kemi me bizneset vendore, me të vërtetë është knaqësi me punuar me ta, edhe kemi bashkëpunim të mirë. Besoj se për çdo ditë po vijmë tu e forcu bashkëpunimin tonë me ta, kështu që interesi ynë është sa më shumë, me i hapë dyert bizneseve tona në Kosovë, që produktet e tyre me i qitë në Europë e në Gjermani sidomos.

Pyetja se sa kemi kontakte na me diplomacinë, me perfaqesuesit diplomatik në Gjermani, realisht na kemi kontakte shumë, kontaktet tona janë, kontakte informative, kontakte të çështjes së administratës, të dokumentacioneve, mirëpo jo të fokusit ekonomik. Deri tash nuk kemi pasë!

Unë mendoj Liza u pergjigj ne shumë pyetje dhe dha shumë pergjigje.

Unë mendoj që një formë, një platformë digjitale e krijuar, ku bizneset e diasporës kanë qasje në platformë, edhe i shohin mundësitë e investimeve eventuale këtu, është shumë me rëndësi.

Tjetëra, ndoshta edhe Qeveria dhe diplomacia me formu një grup, të njerëzve, të eksperteve, që i takojnë apo i hulumtojnë, resurset në Gjermani të kosovarëve, kompanitë, firmat, shoqatat e ndryshme, krejt me qellim që me pasur një bashkëpunim na.

Tash realisht në vijmë këtu përmes kontakteve që i kemi, njerëzve që edhe na ofrohen edhe ne i kontaktojmë, mirëpo konkret me ditë se cka duhet me ba.

Unë e di që ka shumë nevojë me ba shumë sene, mirëpo ku është interesi jonë, cka mundemi me ba konkret, çka ka nevojë, qysh

mundemi me bërë njëfarë bashkëpunimi, kjo ish me kanë me shumë rëndësi, mirëpo kjo unë besoj, tash pasi po flasim për forma digjitale, platforma ku e sheh secili biznesmen i joni, psh., ose çdo pyetje që dojnë me adrsu, përmes platformës kish me kanë ma mirë, e kemi një adresë, besoj se është një zgjedhje e mirë.

Moderatori z. Loxha, pyetje për z. Viqa, nëse mundem para se me kapercy te z. Berat Rukiqi i Odes Ekonomike të Kosovës, nëse po flasim për profilin e një misioni diplomatik të Kosovës, dhe ju keni bashkëpunim, mendoj në baza relativisht të rregullta me misione të tilla diplomatike.

Nëse po flasim për një vizion të ri për se si mund të konsolidohet koncepti i diplomacisë komerciale në Kosovë. Sipas jush, cili do të duhej të ishte profili i një diplomati komercial, atashë ekonomik ose perfaqesuesi tregtar në një ambasadë ekonomike të Kosovës?

A duhet ai, prej këndvështrimit të diasporës, të jetë nëpunës i rregullt i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i dikujtë që caktohet nga Ministria e Industrisë, Ndermërisë dhe Tregtisë, i dikujtë që mund të ketë bashkëpunim me odat afariste, i një konsulentit të pavaruar, i cili

merr shërbime prej atyre kontakteve që i krijon dhe i ndërmjetson, d.m. th. ju operoni në tregun evropian, dhe e njihni peisazhin në të cilin operoni, dhe nese do te mund ta përshkruani për audiencën këtu.

Cili është profili i diplomatit komercial të cilin Qeveria e Kosovës duhet ta promovojë, meqenëse ekzistojnë modele të ndryshme, se si ky funksion mund të ndërtohet brenda misioneve diplomatike?


Kryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane në Gjermani z. Nazmi VIQA:

Unë mendoj se ky person duhet me pasë aftësi, duhet me qenë aftësi afariste, duhet me qenë diplomat i mirë, duhet me njoftë, po flas për Gjermani, duhet me njoftë mirë edhe ekonominë gjermane, duhet bashkëpunimi në mes institucioneve të ndryshme relevante ekonomike këtu në Kosovë edhe me bizneset e diasporës, me u kriju njëfar lidhje.

Unë besoj se duhet me kanë një ekspert i mirë, edhe që punon shumë, që i kontakton bizneset, ashtu e mendoj unë.

Përfundoi diskutimin e Tij dhe pergjigjen ne pyetjen e moderatrit, Kryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane z Nazmi VIQA!

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH



Patrick MODIANO

Ligjërata e Nobelit, 7 dhjetor 2014

Reminishencat e romansierit

Unë, thjesht, do të doja t'ju thosha se sa i lumtur jam që gjendem këtu me ju dhe sa i prekur jam nga nderi që më keni bërë me dhënien e çmimit Nobel për letërsi.

Është hera e parë që më duhet të mbaj një fjalim para një auditori kaq të madh dhe po ndihem disi i frikësuar për këtë gjë. Është e lehtë të imagjinohet se kjo lloj gjëje i vjen natyrshëm dhe lehtë një shkrimtari. Por një shkrimtar – të them, së paku një romansier – shpesh ka një marrëdhënie të vështirë me fjalën. Duke kujtuar mënyrën sesi mësimet shkollore bëjnë dallimin midis të shkruarës dhe gojores, një romansier ka më shumë talent për detyra me shkrim sesa për ato me gojë. Ai është mësuar të heshtë dhe, nëse dëshiron të krijojë një atmosferë, ai duhet të përzihet me turmën. Ai dëgjon biseda pa u dukur dhe, nëse futet në këtë, e bën gjithmonë në mënyrë që të bëjë disa pyetje diskrete që ta përmirësojë kuptimin e tij për gratë dhe burrat përreth tij. Fjalimi i tij është hezitues ngaqë ai është mësuar t'i kapërcejë fjalët e tij. Është e vërtetë që pas disa rirreshtimeve stili i tij mund të

jetë i qartë si kristali. Por, kur merr fjalën, ai nuk ka më asnjë mjet në dispozicion për ta korrigjuar fjalimin e tij përpëlitës.

Edhe unë i përkas një brezi në të cilin fëmijët janë parë, por nuk janë dëgjuar, përveç në raste të caktuara të rralla dhe vetëm pasi të kishin kërkuar leje. Por askush nuk i dëgjonte dhe njerëzit shpesh flisnin përtej tyre. Kjo shpjegon vështirësinë që disa prej nesh kanë kur flasim – herë hezitojnë, herë shumë shpejt sikur presin që të ndërpriten në çdo çast. Kjo është, ndoshta, arsyeja pse dëshira për të shkruar më erdhi, si shumë të tjerëve, në fund të fëmijërisë sime. Ju shpresoni që të rriturit do të lexojnë ato që shkruani. Në atë mënyrë ata do të duhet t'ju dëgjojnë pa ndërprerë dhe ata do ta dinë mirë se çfarë keni në gjoks.

Shpallja e këtij çmimi më dukej joreale dhe isha i etur të dija pse më zgjodhët mua. Atë ditë nuk mendoj se kisha qenë ndonjëherë më i vetëdijshëm se sa i verbër është një romansier kur bëhet fjalë për librat e tij dhe se sa më shumë dinë lexuesit për ato që ai ka shkruar sesa ai. Një

romansier nuk mund të jetë kurrë lexuesi i vet, përveç kur herr dorëshkrimin e tij nga gabimet sintaksore, përsëritjet e ndonjë paragrafi të tepërt të rastit. Ai nuk ka pos një përshtypjeje të pjesshme dhe të hutuar mbi librat e tij, si një piktor që krijon një afresk në tavan, i shtrirë në një skelë dhe duke punuar me detajet, shumë afër, pa asnjë vizion të veprës së tërësi.

Të shkruarit është një aktivitet i çuditshëm dhe i vetmuar. Ka raste shpërdoruese kur filloni të punoni në faqet e para të një romani. Çdo ditë keni ndjenjën se jeni në rrugën e gabuar. Kjo krijon një dëshirë të fortë për t'u kthyer dhe për të ndjekur një rrugë tjetër. Është e rëndësishme të mos i nënshtroheni këtij gjakimi, por të vazhdoni. I ngjanë paksa ngasjes së një makine gjatë natës, në dimër, në akull, me shikueshmëri zero. Ju nuk keni zgjidhje, nuk mund të ktheheni në anën e kundërt, duhet të vazhdoni përpara, ndërsa i thoni vetes se gjithçka do të jetë mirë kur rruga të bëhet më e qëndrueshme dhe mjegulla të davaritet.

Kur do të mbaroni një libër

ndiheni sikur ai po fillon të shkëputet dhe tashmë po merr frymën e lirisë, si nxënësit në shkollë në klasë një ditë para pushimit të verës. Ata janë të shpërqendruar dhe të zhurmsëm dhe nuk i kushtojnë më vëmendje mësuesit të tyre. Unë do të shkoja aq larg sa të thosha që, derisa shkruani paragrafët e fundit, libri shfaq një farë armiqësie për nxitimin e tij për t'u çliruar nga ju. Dhe të lë, mezi të jep kohë të shkruash fjalën e fundit. Ka mbaruar – libri nuk ka më nevojë për ju dhe tashmë ju ka harruar. Ka dhe një lloj zhgënjimi për shkak të kësaj lidhjeje midis jush dhe librit që u shkëput tepër shpejt. Pakënaqësia dhe ndjenja e diçkaje të papërfunduar ju shtyn ta shkruani librin tjetër, në mënyrë që ta rivendosni ekuilibrin, diçka që nuk ndodh kurrë. Ndërsa vitet kalojnë, librat ndjekin pas njëri-tjetrit dhe lexuesit flasim për një 'trup pune'. Por për ju, ekziston një ndjenjë se e gjitha ishte vetëm një nxitim theqafës përpara.

Kështu që po, lexuesi di më shumë për një libër sesa vetë autori. Diçka ndodh midis një romani dhe lexuesit të tij, që

është e ngjashme me procesin e zhvillimit të fotografive, mënyrën se si ata e bënin atë para epokës digjitale. Fotografia, siç ishte shtypur në dhomën e errët, bëhej e dukshme pak nga pak. Ndërsa lexoni rrugën tuaj përmes një romani, zhvillohet i njëjti proces kimik. Por që të ekzistojë një harmoni e tillë midis autorit dhe lexuesit të tij, është e rëndësishme që kurrë të mos e teproni me lexuesin – në kuptimin që flasim për këngëtarë, që e tejkalojnë zërin e tyre – por për ta qortuar atë në mënyrë të padukshme, duke lënë hapësirë të mjaftueshme që libri ta përshkojë pak nga pak, me anë të një arti që i ngjan akupunkturës, në të cilën gjilpëra thjesht duhet të futet pikërisht në vendin e duhur për ta çliruar rrjedhën në sistemin nervor. Ma ha mendja se edhe bota e muzikës ka një ekuivalent me këtë marrëdhënie intime dhe plotësuese midis romansierit dhe lexuesit të tij. Gjithmonë kam menduar se shkrimi është afër muzikës, ndonëse më pak i pastër dhe gjithmonë u mbaj zili muzikantëve që, për mendjen time, praktikojnë një art që është

më i lartë se romani. Poetët, gjithashtu, janë më pranë muzikantëve sesa romancierëve. Kam filluar të shkruaj poezi që si fëmijë, dhe sigurisht që kjo është arsyeja pse një vërejtje që lexova diku më goditi aq shumë: 'Shkrimtarët e prozës krijohen nga poetë të këqij'. Për një romancier, në kuptim të muzikës, kjo shpesh është çështje e mprehtësisë së të gjithë njerëzve, peizazheve, rrugëve që ai ka qenë në gjendje të vëzhgojë në një rezultat muzikor që përmban të njëjtat fragmente melodike nga një libër në tjetrin, por që atij do t'i duket se është i papërsosur. Novelisti atëherë do të pendohet që nuk ka qenë një muzikant i pastër dhe që nuk ka kompozuar *Nokturnot* e Shopenit.

Mungesa e vetëdijes dhe distancës kritike të një romancieri ndaj objektit të tij të punës ndodh për shkak të një fenomeni që kam vërejtur te vetja dhe te shumë të tjerë: sa më shpejt që të shkruhet, çdo libër i ri fshin atë të fundit, duke më lënë me përshtypjen se e kam harruar. Kisha menduar se po shkruaja libra njëri pas tjetrit në një mënyrë të shkëputur, në periudha të njëpasnjëshme të harrësës, por shpesh të njëjtat fytyra, të njëjtët emra, të njëjtat vende, të njëjtat fraza vazhdojnë të rikthehen në libër pas libri, si mostra në një sixhade të endur gjysmë i fjetur. Gjysmë i fjetur apo duke ëndërruar ditën. Një romancier shpesh është një somnambul, aq i zhytur është në atë që duhet të shkruajë dhe është natyrisht shqetësuese kur kalon rrugën në rast se e përplasim. Mos harroni, megjithatë, saktësinë ekstreme të personave që ecin në gjumë që ecin mbi çati pa u rrezuar kurrë.

Fraza që më ra në sy në deklaratën pas shpalljes së këtij çmimi Nobel ishte një aludim mbi Luftën e Dytë Botërore: 'ai zbuloi botën e jetës në pushtim'. Si të gjithë të tjerët të lindur më 1945, unë isha një fëmijë i luftës dhe, më saktësisht, sepse kam lindur në Paris, një fëmijë që i detyrohej lindjes së tij, Parisit të pushtimit. Ata që jetuan në atë Paris dëshironin ta harronin atë shumë shpejt ose, të paktën, të mbanin mend vetëm hollësitë e përditshme, ato që paraqitnin iluzionin se jeta e përditshme nuk ishte aq ndryshe nga jeta që ata bënë në kohë normale. E gjitha ishte një ëndërr e keqe, me pendesën e paqartë për të qenë në një farë kuptimi të mbijetuar. Më vonë, kur fëmijët e tyre u bënë pyetje në lidhje me atë periudhë dhe atë Paris, përgjigjet e tyre ishin evazive. Ose, në të kundërtën, ata heshtnin sikur donin të shpëlanin ato vite të errëta nga kujtesa e tyre dhe të mbanin

diçka të fshehur prej nesh. Por, të ballafaquar me heshtjen e prindërve tanë, ne i kuptonim të gjitha sikur t'i kishim jetuar vetë. Ai Paris i pushtimit ishte një vend i çuditshëm. Në sipërfaqe jeta vazhonte 'si më parë' – teatrot, kinematë, sallat e muzikës dhe restorantet ishin të hapura për biznes. Kishte këngë që luanin në radio. Pjesëmarrjet në teatër dhe kinema ishin, në fakt, shumë më të larta se para luftës, sikur këto vende të ishin strehimore ku njerëzit mblidheshin dhe përqesheshin pranë njëri-tjetrit për t'u siguruar. Por ka detaje të çuditshme që tregojnë se Parisi nuk ishte aspak si më parë. Mungesa e makinave e shndërroi atë në një qytet të heshtur – një heshtje që shpallonte shushurimën e pemëve, mprehtësinë e thundrave të kuajve, zhurmën e hapave të turmës dhe zhurmën e zërave. Në heshtjen e rrugëve dhe ndërprerjes së errët të vendosur rreth orës pesë të dimrit, gjatë së cilës ndalohej drita më e vogël nga dritaret, ky qytet dukej sikur i mungonte vetvetes – qyteti 'pa sy', siç thoshin pushtuesit nazistë. Të rriturit dhe fëmijët mund të zhdukeshin pa lënë gjurmë nga një çast në tjetrin dhe, madje, edhe midis miqve, asgjë në të vërtetë nuk thuhej hapur dhe bisedat nuk ishin kurrë të sinqerta për shkak të ndjenjës së kërcënimit në ajër.

Në këtë Paris, nga një ëndërr e keqe, ku dikush mund të denoncohej ose të kapej në një ndonjë arrestim masiv në dalje të ndonjë stacioni të metrosë, takime të rastësishme zhvilloheshin midis njerëzve, rrugët e të cilëve nuk do të takoheshin kurrë në kohë paqeje, lidhje të brishta dashurie lindnin në errësirat e shtettrrethimit, pa asnjë siguri takimi përsëri në ditët që pasonin. Më vonë, si pasojë e këtyre takimeve shpesh jetëshkurtra dhe ndonjëherë të paqarta, lindnin fëmijë. Kjo është arsyeja pse për mua Parisi i pushtimit ishte gjithmonë një lloj errësire e lashtë. Pa të nuk do të kisha lindur kurrë. Ai Paris nuk pushoi së më ndjekuri dhe librat e mi lahen herë-herë në dritën e tij të mugët. Dhe këtu qëndron prova se një shkrimtar shënjohej në mënyrë të pashlyeshme me datën e lindjes së tij dhe nga koha e tij, edhe nëse ai nuk ishte i përfshirë drejtpërdrejt në veprim politik, edhe nëse ai jep përshtypjen e një të vetmuari të mbyllur në atë që njerëzit e quajnë 'kulla e tij e fildishtë'. Nëse ai shkruan poezi, ato pasqyrojnë kohën në të cilën ai jeton dhe që nuk do të ishin shkruar kurrë në një epokë tjetër. Kjo është veçanërisht e vërtetë në një poezi të Jeitsit

(Yeats), shkrimtarit të madh irlandez, të cilin gjithmonë e kam parë thellësisht prekëse: *Mjellmat në Coole*. Në një park Jeits kundron disa mjellma që rrëshqasin mbi ujë:

Vjeshta e nëntëmbëdhjetë më ka ardhur
Qëkur për herë të parë fillova t'i numëroja;
Pashë, para se të kisha mbaruar mirë,
Fare papritmas krrokamat
Dhe kërcitjet e rrotave në vargonj të thyer
Mbi krahët e tyre zhurmëmëdhjenj.

Por tani ato rrëshqasin mbi ujin e qetë
Misterioze, plot hirësi;
Ndër ç'guva vallë do të mbarojnë,
Në ç'tef pellgu a liqeni
Për kënaqësinë e burrave, kur do të zgjohem një ditë
E të shoh se si ato kanë ikur larg?

Mjellmat shfaqen shpesh në poezinë e shekullit XIX – te Bodleri (Baudelaire) apo te Malarmeu (Mallarmé). Por kjo poezi nga Jeitsi nuk mund të ishte shkruar në shekullin XIX. Ajo ka një ritëm të veçantë dhe një melankoli që e vendos atë në shekullin XX, madje edhe në vitin në të cilin është shkruar.

Një shkrimtar i shekullit XX gjithashtu mund të ndihet herë-herë në kohën e tij dhe leximi i romancierëve të mëdhenj të shekullit XIX – Balzaku, Dikensi, Tolstoj, Dostojevski – mund të sjellë njëfarë nostalgjie. Në ato ditë koha kalonte më ngadalë sesa sot dhe kjo ngadalësi i përshtatej veprës së romancierit sepse i lejoi atij ta marshonte

energjinë dhe vëmendjen e tij. Koha është përsheptuar që nga ajo etapë dhe ecën përpara sa çelë e mbyll sytë – duke shpjeguar ndryshimin midis ngrehinave të larta letrare të së kaluarës, me arkitekturën e tyre të ngjashme me katedralen dhe veprave të ndara dhe të copëzuara të së sotmes. Nga kjo pikëpamje, gjenerata ime paraqet një tranzicion, dhe unë do të isha kurioz të dija se si brezat e ardhshëm, të lindur me internet, telefona celularë, postë elektronike dhe cicërima, do të shprehin përmes letërsisë këtë botë në të cilën të gjithë janë përgjithmonë 'të lidhur' dhe ku 'rrjetet sociale' po ushqehen me atë pjesë të intimitetit dhe fshehtësisë që ishte ende fusha jonë deri në kohët e fundit – sekretit që u dha thellësi individëve dhe që mund të bëhej temë kryesore në një roman. Por unë do të qëndroj optimist për të ardhmen e letërsisë dhe jam i bindur që shkrimtarët e së ardhmes do ta ruajnë trashëgiminë ashtu siç ka bërë çdo brez që nga Homeri e këtej...

Dhe, përveç kësaj, një shkrimtar gjithmonë arrin të shprehë diçka të përrjetshme në veprën e tij edhe nëse ai, si çdo artist tjetër, është aq i lidhur me moshën e tij sa nuk i shpëton dot asaj dhe ajri i vetëm që merr frymë është ajri i *zeitgeist*-it. Në veprat e Racinit apo të Shekspirit, ka pothuajse pak rëndësi nëse personazhet janë të veshur me kostum periudhe apo regjisori dëshiron t'i vendosë me xhinse dhe me një xhakë të lëkure. Këto janë hollësi të parëndësishme. Derisa lexojmë Tolstojin, Ana Karenina ndihet aq afër nesh pas një shekulli e gjysmë saqë harrojmë

se ka veshur fustane nga viti 1870. Dhe, ka disa shkrimtarë, si Edgar Allan Po, Melvilli apo Stendali, të cilët kuptohen më mirë dy shekuj pas vdekjes së tyre nga ç'kuptoheshin nga bashkëkohësit e tyre. Në fund të fundit, sa larg mbetet saktësisht një romancier? Në kufijtë e jetës për ta përkthyer atë, sepse nëse zhyteni në të – në veprim – imazhi që keni për të është i përzier. Por kjo distancë e lehtë nuk e kufizon aftësinë e autorit për t'u identifikuar me personazhet e tij dhe njerëzit që e frymëzojnë atë në jetën reale. Flobri (Flaubert) tha: 'Madam Bovari jam unë'. Tolstoj menjëherë u identifikua me gruan që ai pa duke u hedhur poshtë një treni natë në një stacion në Rusi. Kjo dhuratë e identifikimit shkoi aq larg saqë Tolstoj u shkri me qiellin dhe peizazhin që ai po përshkruante dhe që e kapërdinë plotësisht, deri në rënien më të vogël të qerpikut të Ana Kareninës. Kjo gjendje e transponimit është e kundërta e narcizmit, pasi nënkupton një ndërthurje të njëkohshme të vetëharrësës me përqendrim suprem në mënyrë që të mos humbasin hollësitë më të vogla. Kjo bart me vete edhe një vetmi të caktuar. Kjo nuk do të thotë kthim brenda, por ju lejon të arrini një shkallë të vëmendjes dhe hiperkthjellësisë kur vëzhgoni botën e jashtme, e cila më pas mund të transferohet në një roman.

Kam menduar gjithmonë se poetët dhe romancierët janë në gjendje t'i veshin individët me një mister, duke i bërë të mbingarkuar nga jeta e përditshme dhe gjërat që duken banale – dhe arsyeja që ata mund ta bëjnë këtë është ngaqë ata i kanë vëzhguar ata herë pas herë me vëmendje pothuajse hipnotikisht të qëndrueshme. Nën vështrimin e tyre, jeta e përditshme përfundon duke u mbështjellë me mister dhe duke marrë një lloj cilësie shkëlqimi në errësirë, të cilën nuk e kishte në shikim të parë, por që ishte fshehur thellë poshtë. Është roli i poetit dhe romancierit, si dhe i piktorit, që ta zbulojë misterin dhe cilësinë shkëlqim-në-errësirë që ekziston në thellësitë e çdo individi. I afërmi im i largët, piktori Amedeo Modigliani (Modigliani), më vjen në mendje. Në pikturat e tij më tërheqëse, modelet që ai zgjodhi ishin njerëz anonimë, fëmijë dhe vajza rruge, çupa, fermerë të vegjël, çirakë të rinj. Ai i pikturonte ato me një rënie intensive të furçës, që kujton traditën e madhe toskane – Botičelin (Botticelli) dhe piktorët sienezë të Kuartoçentos. Ai, gjithashtu, u dha atyre – ose më saktë ua zbuloi – të gjithë hirin dhe fisnikërinë që ishte brenda



tyre, nën pamjen e tyre të përlurur. Vepra e një romansieri duhet të shtegtojë në të njëjtin drejtim. Imagjinata e tij, larg nga shtrembërimi i realitetit, duhet ta marrë fundin e saj, duke zbuluar këtë realitet në vetvete, duke përdorur fuqinë e infra të kuqes dhe ultravjollcës për të zbuluar atë që fshihet prapa aparençave. Gati sa mund të besojë se romansieri, në rastin më të mirë të tij, është një lloj i kthjellët apo edhe vizionar. Ai është, gjithashtu, një sizmograf, që qëndron afër për të kapur lëvizje mezi të perceptueshme. Unë gjithmonë mendoj dy herë para se ta lexoj biografinë e një shkrimtari që admiroj. Biografët nganjëherë futen në hollësi të vogla, tregime jo të besueshme të dëshmitarëve okularë, tipare karakteri që duken të çuditshme ose zhgënjyese – të gjitha këto janë si tingulli zhurmues që ngatërrojnë transmetimet në radio, duke e bërë muzikën dhe zërat të pamundur të dëgjohen. Vetëm duke lexuar librat e tij fitojmë intimitet me një shkrimtar. Kjo ndodh kur ai është në më të mirën e tij dhe na flet me zë të ulët dhe pa ndonjë statikë.


Megjithatë, kur lexoni biografinë e një shkrimtari, ju herë pas herë zbuloni një ngjarje të rëndësishme fëmijërie e cila mbolli farën e objektit të tij të ardhshëm të punës dhe për të cilën ai nuk kishte gjithmonë një ndërgjegje të pastër, si një ngjarje e shquar që rikthehet me rroba të ndryshme për t'i ndjekur librat e tij. Kjo sjell ndërmend Alfred Hiçkokun, jo si një shkrimtar, por si dikush filmat e të cilit gjithsesi kanë forcën dhe kohezionin e një romani. Kur djali i tij ishte pesë vjeç, babai i Hiçkokut i tha që të dërgonte një letër te një oficer policie, mik i tij. Djaloshi ia dorëzoi letrën dhe oficeri i policisë e mbylli atë në pjesën e kontrolluar të stacionit të policisë, që përdoret si një qeli që mban të gjitha llojet e shkelësve të veprave brenda natës. Fëmija i tmerruar qëndroi aty për një orë të tërë para se oficeri i policisë ta lironte, duke i shpjeguar, 'tani ju e dini se çfarë ndodh nëse silleni keq në jetë'. Ky oficer policie, me idetë e tij mjaft të çuditshme në lidhje me rritjen e fëmijëve, duhet të ketë qëndruar prapa atmosferës së suspensës dhe ankthit që gjendet në të gjithë filmat e Alfred Hiçkokut.

Unë nuk do t'ju shqetësoja me historinë time personale, por mendoj se disa episode nga fëmijëria ime mbollën farën që do të rritej më vonë në librat e mi. Unë zakonisht isha larg prindërve të mi, duke qëndruar me miqtë për të cilët nuk dija asgjë, në një sërë vendesh dhe shtëpish. Në atë kohë asgjë nuk

e habit një fëmijë, madje situatat e çuditshme duken krejtësisht të natyrshme. Shumë më vonë ajo fëmijëria ime më bëri përshtypje si enigmatike dhe u përpoqa të mësoja më shumë rreth njerëzve të ndryshëm me të cilët më lanë prindërit dhe ato vende që vazhdonin të ndryshonin. Por unë nuk isha në gjendje ta identifikoja shumicën e njerëzve dhe as t'i gjeja të gjitha vendet dhe të gjitha shtëpitë e së kaluarës me ndonjë saktësi topografike. Kjo përpiqej për t'i zgjidhur enigmat pa pasur sukses të vërtetë dhe për t'u përpiqur të zbuloj një mister më dha dëshirën për të shkruar, sikur shkrimi dhe imagjinata mund të më ndihmonin t'i lidhja përfundimisht të gjitha ato skaje të shkëputura.

Meqë po flasim për 'mister', shoqata e ideve sjell ndërmend titullin e një romani francez të shekullit XIX: *Les mystères de Paris*. Qyteti – që ka qëlluar të jetë Parisi, qyteti im i lindjes – është i lidhur me përshtypjet e mia të para të fëmijërisë dhe këto përshtypje ishin aq të forta sa që prej asaj kohe unë kam eksploruar vazhdimisht 'misteret e Parisit'. Kur isha rreth nëntë apo dhjetë vjeç, ndodhi që unë isha duke ecur vetëm dhe, edhe pse kisha frikë se mos humbisja, vajta gjithnjë e më tej në lagjet me të cilat nuk isha i njohur në bregun e djathtë të Senës. Kjo ndodhi në dritë të ditës, gjë që më siguronte. Në fillim të adoleshencës kam punuar shumë për ta kapërcyer frikën time dhe të dilja gjatë natës edhe më larg me metro. Kështu mësoni për qytetin dhe unë po ndiqja shembullin e shumicës së romansierëve që admiroja dhe për të cilët, që nga shekulli XIX, qyteti – ta quajmë Paris, Londër, Shën Petersburg apo Stokholm – ishte sfondi dhe një nga temat kryesore të librave të tyre. Në tregimin e tij të shkurtër 'Njeriu i turmës', Edgar Allan Poe ishte ndër të parët që evokoi dallgët e njerëzve siç i vëzhgon nga një dritare kafeneje, duke ecur në trotuare pareshtur. Ai zgjedh një plak me një pamje të pazakontë dhe e ndjek gjatë natës në pjesë të ndryshme të Londrës në mënyrë që të mësojë më shumë për të. Por personi i panjohur është një 'njeri i turmës' dhe është e pakuptimtë ta ndjekësh atë sepse ai do të mbetet gjithmonë anonim dhe nuk do të jetë kurrë e mundur të zbulosh ndonjë gjë rreth tij. Ai nuk ka një ekzistencë individuale. Ai, thjesht, është pjesë e masës së kalimtarëve që ecin në radhë serike ose duke u gajatur dhe humbur në mes të turmës në rrugë.

Më kujtohet, gjithashtu, diçka që i ndodhi poetit Thomas de Kuinsi (Quincey) kur ishte i ri



dhe që e shenjësosi atë për gjithë jetën. Në Londër, në mes të turmës në Oxford Street, ai u miqësua me një vajzë, një nga ato takimet e rastësishme që ndodhin në një qytet. Ai kaloi disa ditë në shoqërinë e saj, pastaj iu desh të largohej nga Londra për disa ditë. Ata ranë dakord që pas një jave ajo do ta priste në të njëjtën kohë çdo mbrëmje në cep të Great Titchfield Street, por ata nuk u panë më kurrë. 'Po të ketë qenë gjallë, pa dyshim që duhet të kemi kaluar ca kohë në kërkim të njëri-tjetrit, në të njëjtin çast, nëpër labirintet e fuqishme të Londrës, duke qenë ndoshta edhe disa hapa larg njëri-tjetrit – një pengesë jo më e gjerë se një rrugë e Londrës që shpesh çon në fund të një ndarjeje të përjetshme'.

Me kalimin e viteve, çdo lagje, çdo rrugë në një qytet ngjall një kujtim, një takim, një keqardhje, një çast lumturie për ata që kanë lindur aty dhe kanë jetuar aty. Shpesh e njëjta rrugë lidhet me kujtime të njëpasnjëshme, në masën që topografia e një qyteti bëhet e gjithë jeta juaj, e mbajtur në mend në shtresa të njëpasnjëshme sikur të deshifronit shkrimet e mbivendosura në një palimpsest. Dhe, gjithashtu, jeta e mijëra e mijëra njerëzve të tjerë, të panjohur, që kalojnë nëpër rrugë ose në rrugët e pas kalimit në metro në orët e pikut. Kjo është arsyeja pse në rininë time, për të më ndihmuar të shkruaj, u përpoqa t'i gjeja drejtoritë e vjetra telefonike parisiane, veçanërisht ato që rendisnin emrat e rrugëve me numrat e ndërtesave. Kisha ndjesinë, derisa ktheja faqet, se po shikoja një rreze X të qytetit – një qytet i zhytur si Atlantisi – dhe duke ndier firomën e kohës. Për shkak të viteve që kishin kaluar, gjurmët e vetme që kishin lënë këta mijëra e mijëra individë të panjohur ishin emrat, adresat dhe numrat e tyre të telefonit. Ndonjëherë një emër zhduket nga një vit në tjetrin. Kishte diçka marramendëse për të parë nëpër librat e vjetër të telefonit

dhe për të menduar që tani e tutje, thirrjet drejt atyre numrave do të ishin pa përgjigje. Më vonë do të më godasin strofat e një poezie të Osip Mandelstamit:

U ktheva në qytetin tim të mësuar me lotët,
Tek varkat e mia dhe flegrat e viteve të fëmijërisë,

Petersburg [...]

Ndërsa i mbani gjallë numrat e mi të telefonit.

Petersburg, unë ende i kam adresat

Që do t'i përdor për ta zgjuar zërin e të vdekurve.

Kështu që më duket se dëshira për t'i shkruar librat e mi të parë më lindi derisa isha duke parë ato libra të vjetër telefonikë të Parisit. Gjithçka që duhej të bëja ishte të nënvizoja me laps emrin, adresën dhe numrin e telefonit të një personi të panjohur dhe të imagjinoja si ishte jeta e tij/saj, midis qindra e qindra mijëra emrave.

Ju mund ta humbni veten ose të zhdukeni në një qytet të madh. Ju, madje, mund ta ndryshoni identitetin tuaj dhe të bëni një jetë të re. Ju mund të kënaqeni me një hetim shumë të gjatë për të gjetur një gjurmë keqdashjeje, duke filluar vetëm me një ose dy adresa në një lagje të izoluar. Gjithmonë jam magjepsur nga shënimi i shkurtër që ndonjëherë shfaqet në regjistrat e kërkimit: *Adresa e fundit e njohur*. Temat e zhdukjes, identitetit dhe kalimit të kohës janë të lidhura ngushtë me topografinë e qyteteve. Kjo është arsyeja pse që nga shekulli XIX qytetet kanë qenë territori i romansierëve dhe disa nga më të mëdhenjtë prej tyre janë të lidhur me një qytet të vetëm: Balzaku dhe Parisi, Dikensi dhe Londra, Dostojevski dhe Shën Petersburgu, Tokio dhe Nagai Kafu, Stokholmi dhe Hjalmar Söderberg.

Unë i përkas brezit që u ndikua nga këta romansierë dhe që donte, nga ana tjetër, të eksploronte atë që Bodleri (Baudelaire) e quajti "skutat

dredharake të kryeqyteteve të vjetra". Pa dyshim, pesëdhjetë vjet më parë – me fjalë të tjera kur adoleshentët e moshës sime po përjetonin ndjesi të fuqishme duke zbuluar qytetin e tyre – qytetet po ndryshonin. Disa prej tyre, në Amerikë dhe atë që njerëzit e quajnë bota e tretë, u bënë 'megaqytete' duke arritur dimensione shqetësuese. Banorët janë të ndarë në lagje shpesh të lëna pas dore, duke jetuar në një klimë të luftës shoqërore. Lagjet e varfra po rriten në numër dhe po bëhen gjithnjë e më të mëdha. Deri në shekullin XX romansierët mbajtën një vizion pak a shumë 'romantik' të qytetit, jo aq të ndryshëm nga ai i Dikensit apo Bodlerit. Kjo është arsyeja pse unë do të doja të dija se si romansierët e së ardhmes do të evokojnë këto përqendrime gjigande urbane në veprat e fiksionit.

Lidhur me librat e mi, ju ishit aq dashamirës sa të aludonit në 'artin e kujtesës me të cilin ai ka evokuar fatet më të pakapshme njerëzore'. Por ky kompliment ka të bëjë më shumë sesa vetëm me mua. Bëhet fjalë për një lloj kujtese të veçantë e cila përpriqet të mbledhë copëza nga e kaluara dhe gjurmët e pakta të mbetura në tokë të anonimes dhe të së panjohurës. Dhe kjo, gjithashtu, lidhet me vitin e lindjes sime: 1945. Të lindurit në vitin 1945, pasi qytetet ishin shkatërruar dhe popullata të tëra ishin zhdukur, duhet të më ketë bërë mua, si të tjerët të moshës sime, më të ndjeshëm ndaj temave të kujtesës dhe harresës.

Për fat të keq, nuk mendoj se rikujtimi i gjërave të kaluara mund të bëhet më gjatë me fuqinë dhe sinqeritetin e Marsel Prustit (Proust). Shoqëria që ai po përshkruante ishte ende e qëndrueshme, një shoqëri e shekullit XIX. Kujtesa e Prustit bën që e kaluara të rishfaqet në të gjitha detajet e saj, si një tablo e gjallë. Sot kam kuptimin se kujtesa është shumë më pak e sigurt për vetveten, e angazhuar kështu në një luftë të vazhdueshme kundër amnezisë. Kjo shtresë, kjo masë e harresës që errëson gjithçka, do të thotë që ne mund të kapim vetëm fragmente të së kaluarës, gjurmë të shkëputura të fateve të shkuara dhe pothuajse të porealizueshme njerëzore.

Megjithëse, duhet të jetë thirrja e romansierit, kur përballet me këtë faqe të madhe bosh të harresës, për t'i bërë disa fjalë të venitura përsëri të dukshme, si ajsbergët e humbur që shtrihen mbi sipërfaqen e oqeanit.

Marrë nga numri i 11-të i revistës për letërsi, kulturë, gjuhë, media, "Akademia".

Përktheu: Avni SPAHIU.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Spanja eliminon Zvicrën vetëm pas penalltive, në gjysmëfinale përballet me Italinë



Munchen, 2 korrik - Spanja e ka eliminuar Zvicrën nga Kampionati Evropian "Euro 2020", vetëm pas ekzekutimit të penalltive me rezultat 3-1. Zvicra pati paraqitje të mirë në ndeshjen çerekfinale, por eliminohet nga kompeticioni ku kaloi prishmeritë. Në minutën e tetë, Spanja kaloi në epërsi me autogolin e Denis Zakaria. Ndërsa në pjesën e dytë, Zvicra ishte dukshëm skuadër me e mirë dhe arriti të barazoi rezultatin nëpërmjet futbollistit shqiptar nga Gjilani, Xherdan Shaqiri, i cili realizoi në minutën e 68-të. Dhjetë minuta me vonë Zvicra mbeti a një lojtar, pasi me karton të kuq u ndëshkua Remo Freuler. Pavarësisht se mbeti me një lojtar me pak, Zvicra e mbylli kohën e rregullt me rezultat 1-1. Në vazhdimë, Spanja pati dominimin total, por portieri Sommer ishte i pathyeshëm. Ndërsa Italia e ka siguruar një vend për në gjysmëfinale kundër Spanjës. "Të Kaltrit" triumfuan me meritë 2-1 kundër Belgjikës, në duelin e cilësuar si finale e parakohshme. Italia zhbllokoi sfidën që në minutën e 13-të me Bonuccin, por që do të anulohet për shkak të një pozicioni jashtë loje. Goli gjithsesi nuk do të vononte. Në minutën e 31-të pas një aksioni të gjatë, Barella përballë tri mbrojtësve krijon hapësirën e duhur për të lëshuar një të djathtë të hidhur që shkoi në

rretë. Skuadra e Mançinit luan bukur dhe arriti që të dyfishonte shifrat me një "perlë" të Lorenzo Insignes nga distanca, teksa topi shkoi në trekëndësh Belgjika u kundërpërgjigj menjëherë pas pak sekondash duke fituar një penallti me Doku, teksa nga pika e bardhë Lukaku arriti që të mposhtë portierin Donnaruma. Në pjesën e dytë Italia dominon me një lojë

shumë të qartë dhe sulmuese, ndërkohë që Belgjika shpërdoroi dy mundësi shumë të mira me Thorgan Hazard dhe Lukakun. Spinazzola pësoi një dëmtim të rëndë, teksa doli nga fusha mes lotësh. Me shumë mundësi Evropiani ka marrë fund këtu për të. Rezultati nuk ndryshoi deri në fund, teksa Italia tashmë do të masë forcat me Spanjën.



"EURO 2020"

Kroosi pensionohet nga Kombëtarja e Gjermanisë

Toni Kroos është tërhequr zyrtarisht nga Kombëtarja e Gjermanisë. Mesfushori i Realit të Madridit ka njoftuar vetë lajmin me anë të një postimi në profilin e vet në rrjetin social "Instagram". Kroos ka luajtur për kombëtaren gjermane në 106 ndeshje ku ka shënuar 17 gola. Në këtë mënyrë "panterat" humbasin një nga mesfushorët më të mirë në vitet e fundit. "Kam luajtur për Gjermaninë 106 herë. Nuk do të ketë një herë tjetër. Unë këtë vendim e kisha marrë për t'u tërhequr pas këtij turneu disa kohë më parë. Ishte e qartë për mua prej kohësh se nuk do të isha në Kupën e Botës 2022 në Katar", ka thënë Kroos.

Presidenti Le Graet zbulon arsyen e eliminimit të Francës

Eliminimi i Francës në "Euro 2020" është shoqëruar me polemika të shumta jashtë fushave të lojës. Përveç grindjeve mes familjarëve, Federata Franceze e Futbollit (FFF) ka zbuluar një nga gabimet që ka ndikuar negativisht. "Mjaft kemi folur për hotelin. Ne nuk humbëm për shkak të hotelit. Ishte qendra stërvitore që me të vërtetë nuk ishte e mirë, duhet ta pranojmë. Nëse arrijmë në pikën që të themi se nëse do ta kishim ndryshuar hotelin, nuk do të kishim pësuar dy golat ndaj Zvicrës, do të ishte gabim. Në futboll, kur fiton, të gjithë janë të shkëlqyer, kur humbet, është faji i dikujt tjetër. Nuk jam dakord për këtë gjë. Kemi luajtur tri ndeshjet e para shumë mirë, më pas humbëm të katërtën. Duhet të flasim për futboll, pjesa tjetër nuk ka rëndësi", ka thënë presidenti i FFF-së, Noel Le Graet.

Zinchenko: Anglia nuk duhen të na frikësojë, por të na motivojë

Ylli i Ukrainës, Oleksandr Zinchenko, ka thënë se ai njih shumë lojtarë personalisht pasi me shumicën prej tyre ka pasur rastin të luajë në Premierligë. "Kam shikuar të gjitha ndeshjet e tyre, përjashtuar këtë të fundit, pasi ne gjithashtu kishim ndeshje. Gjeja e parë që pashë është se në kampin e tyre njoh shumë lojtarë nga Premierliga, me disa personalisht jam ndeshur me ta", ka thënë Zinchenko. "Është shumë e vështirë të shënosh ndaj tyre, sepse ata janë mjaft të organizuar dhe dinamikë. Gjithashtu, ata kanë bankën rezervë të mirë që kushton sa tri skuadra të Ukrainës. Ata nuk duhen të na frikësojnë, por të na motivojnë. Mendoj se trajneri dhe ekipi teknik do të na tregojnë sesi ta eliminojmë rrezikun ndaj tyre. Unë kam kuptuar që në jetë është gjithçka e mundur dhe ne do të kërkojmë ta bëjmë pikërisht këtë ndaj tyre", ka shtuar Zinchenko.

KFF Mitrovica mëson kundërshtarët në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kampionia e Kosovës në futboll në konkurrencën e femrave, KFF Mitrovica, i ka mësuar kundërshtarët për garën e Ligës së Kampionëve për sezonin 2021/2022. Vashat e

klubit mitrovicas nga shorti i hedhur të premten janë vendosur në grupin e shtatë, ku do të garojnë me skuadrat Valeranga nga Norvegjia, Paok i Greqisë, si dhe skuadra nga Moldavia, Agarista Anenni Noi.

Ndeshjet e këtij grupi do të organizohen në Greqi, që është nikoqire e këtyre skuadrave. Për garat evropiane drejtuesit e këtij klubi kanë paralajmëruar që do të zhvillohet një seancë

përgatitore në Bansko të Bullgarisë. Ndryshe KFF Mitrovica, sikurse në katër sezonet e fundit, ka arritur ta fitojë titullin edhe kupën e Kosovës duke dominuar plotësisht futbollin e femrave.



Dushku: Kemi jetësuar ëndrrën e shumë gjeneratave

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kosova A për herë të parë do të garojë në arenën ndërkombëtare në konkurrencën e femrave. Ishte vendim i Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të formohet Përfaqësuesja A e Kosovës në konkurrencën e femrave dhe të marrë pjesë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla. Në këtë mënyrë u jetësua ëndrra e shumë basketbollistëve që ta veshin fanellën e Kosovës, kurse këtë privilegj nuk e kishin shumë lojtare në të kaluarën, pasi Kosova nuk ishte e pranuar ndërkombëtarisht.

Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka folur për rëndësinë që ka formimi i Përfaqësueses A dhe pjesëmarrja në garat ndërkombëtare. "Shumë gjenerata kanë ëndërruar,

punuar e luajtur me vite të tëra, por nuk kanë pasur mundësi të luajnë për Kosovën A në garat zyrtare. Sot këtë nder dhe kënaqësi e kanë vashat e Kosovës. Ekipi i Kosovës përbëhet nga lojtare me përvojë, por edhe të reja. Besojmë se kjo është mënyra më e duhur për ta përfaqësuar vendin tonë në garat ndërkombëtare", është shprehur Dushku për faqen zyrtare të FBK-së.

Ish-basketbollistja më e mirë në Kosovë thotë se vashat dardane janë të motivuara për një përfaqësim sa më dinjitoz. "Duke parë motivimin e vashave në stërvitje, jam e bindur se do ta japin maksimumin. Është nder dhe krenari të luash për Kosovën. Jemi në një mision shumë të rëndësishëm dhe duam të jemi shembull edhe për



" Kemi jetësuar ëndrrën e shumë gjeneratave "

ELVIRA DUSHKU
Sekretare e Përgjithshme - FBK

gjeneratat e ardhshme", ka shtuar Dushku. "Deri më tani kemi garuar vetëm me përfaqësuese të reja, kurse tashmë edhe me Përfaqësuesen A. Është një ëndërr e realizuar për vashat me përvojë. Vajzat e reja do të kenë motiv më të madh për të punuar në të ardhmen, në mënyrë që një ditë ta përfaqësojnë Kosovën A. Pjesëmarrja në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla nuk është vetëm një garë për ne, por një mision, për të cilin është punuar me vite të tëra", ka nënvizuar ish-basketbollistja e Universitetit të Prishtinës, me të cilën skuadër garoi në Ligën Trocal.

Dushku shton se FBK-ja i

kushton shumë rëndësi basketbollit femëror. "Ne duam ta masivizojmë basketbollin femëror, por edhe duam që ato të qëndrojnë në basketboll, ta vazhdojnë karrierën si trajnere, gjyqtare, administratore apo edhe udhëheqëse në klube të ndryshme. Përpiqemi të mbështesim edhe klubet e basketbollit të femrat dhe personat që janë të angazhuar në basketbollin femëror", ka përfunduar Elvira Dushku. Kampionati Evropian për Shtete të Vogla do të mbahet nga 20 deri më 25 korrik në Qipro. Kosova është në grup me Qipron dhe Luksemburgun, ndërsa në këtë garë marrin pjesë shtatë përfaqësuese.

Bucksi, një hap larg finales së madhe

ATLANTA, 2 KORRIK - Milwaukee Bucks mundi Atlanta Hawksin në sfidën e pestë të serisë finale të Konferencës Lindore, duke marrë avantazhin 3-2 me ndeshje. Skuadra nga Wisconsin triumfoi me rezultatin 112-123 dhe tani Middletoni dhe shokët e tij të skuadrës janë vetëm një fitore larg finales së madhe. Bucks do të ketë sfida në dispozicion, për t'u përballur me pas me Phoenix Suns-in për Unazën e NBA-s. Nga ana tjetër, Hawksi është i detyruar ta fitojë takimin e radhës, që do të luhet



në "State Farm Arena", për të shpresuar më pas triumfin në parketin e Bucks në sfidën e 7-të. Bucks dominoi ndeshjen, me një rezultat 36-22 në periodën e parë, diferencë që u menaxhua me zgjuarsit dhe vendosmëri deri në rënien e sirenës për përfundimin e takimit. Skuadra nga Georgia,

në mungesa të "yllit" të ri, Trae Young, e pati të pamundur ta ngushtonte hendekun dhe ta ndryshonte rrjedhën e lojës. Në këtë sukses të Bucksit luajti rol kryesor Brook Lopez, që ofroi një nga performancat më të mira të karrierës së tij. Ai shënoi 33 pikë, duke qenë i saktë në 14 nga 18 tentativa në total. Nuk mbeti pas Kris Middletoni me 26 pikë, 13 "rebounde" dhe 8 asistime, ndërsa Holiday shtoi 25 pikë dhe 13 asistime. Sa i përket Hawksit, nuk i mjaftuan 28 pikët e Bogdan Bogdanoviqit.

SHKURT

Balde përforcon Dritën

Nënkampionia e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, e ka paraqitur transferimin më të ri, Princ Balde. 23-vjeçari edicionin e fundit ishte pjesë e skuadrës së Feronikelit, ndërsa më herët ka luajtur edhe për Drenicën. "Kemi zyrtarizuar marrëveshjen me mbrojtësin e përfaqësueses së Liberisë, Princ Balde. Balde ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me klubin dhe do të jetë i gatshëm që në ndeshjet e Evropës. 23-vjeçari do ta shtojë edhe më shumë konkurrencën në repartin e mbrojtjes dhe do të jetë një forcë shtesë për ekipin tonë drejt arritjes së qëllimeve tona", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dritës.

Ramosi do të jetë lojtar i PSG-së

Sergio Ramos do të jetë lojtari më i ri i PSG-së. Mediat franceze raportojnë se ish-kapiteni i Real Madridit do t'u bashkohet parisienëve si lojtar i lirë. Ai nuk rinovoi në Madrid dhe u largua nga Reali pas 16 vjetësh karrierë aty duke fituar gjithçka. Edhe me Spanjën, mbrojtësi ka fituar gjithçka teksa 35-vjeçari tashmë do të kalojë një përvojë të re te PSG-ja pas një sezoni shumë të vështirë për shkak të dëmtimeve.

Mourinho pritet nga shumë tifozë në Romë

Jose Mourinho ka zbarkuar në Romë me qindra tifozë të "Giallorossi" që e mirëpresin atë. "Special One" ka nënshkruar një marrëveshje trevjeçare me gigandët e Serisë A dhe Roma do të fillojë para sezonin e tyre më 6 korrik. Presidenti i Romës, Dan Friedkin, ishte personalisht në krye të avionit që solli Mourinho në kryeqytet nga Portugalia, shkruan "Footballitalia". Sipas "Sky Sport Italia", Mourinho tani do të shkojë në Trigoria ku do të kalojë një karantinë pesëditore para fillimit të parasezonit.

Milani mund ta transferojë Jamesin për 10 milionë euro

Milani ia ka vënë syrin James Rodriguezit, i cili mund të largohet nga Evertoni gjatë kësaj vere si rezultat i largimit të papritur të trajnerit Carlo Ancelotti. Mesfushori kolumbian mund t'i bashkohet ekipit kuqezi për 10 milionë euro. Lajmin e ka bërë me dije mediumi "Antena 2". Ish-futbollisti i Portos, Monacos, Real Madridit dhe Bayern Munichut, e ka në tavolinë një kontratë trevjeçare, të cilën e ka bërë gati "Rossoneri". Futbollisti i Evertonit shpreson t'i bashkohet Milanit pasi e kaloi vitin e parë me rënie e ngritje në Premierligë. Ai dëshiron të luajë përsëri në Ligën e Kampionëve dhe këtë mundësi mund t'ia ofrojë gjiganti italian Milan.

Projektohet shkëmbimi Varane - Pogba

Rafael Varane nuk do ta rinovojë kontratën me Realin e Madridit. Sipas asaj që raporton iberikja "AS", mbrojtësit i skadon kontrata pas një viti dhe madrilenët nuk duan që ta humbasin yllin e prapavijës me parametra zero duke projektuar një shkëmbim të bujshëm. Paul Pogba në shkëmbim me Varanen, dy francezë dhe dy shokë skuadre te kombëtarja transalpine mund të shkëmbejnë fanellat që në këtë sesion merkatoje. Nuk dihet ende se çfarë pritet të ndodhë, por nëse do të realizohej si operacion merkatoje, do të ishin një nga goditjet më të bujshme.



Kompania Rajonale për Mbeturina "AMBIENTI" – Zyra Qendrore "Xhem Sadria" p.n. Pejë
Njësitë Operative: Pejë, Klinë e Istog

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës, dhe në përputhje me Rregulloren e brendshme Nr.015, mbi marrëdhënien në punë të punëtorëve, Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "AMBIENTIT" SH.A. Pejë publikon këtë :

KONKURS

Pozita: Arkëtar /e

Detyrat dhe përgjegjësit:

Nën mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv, Menaxherit të Njësisë Operative K.K. Klinë është përgjegjës për:

- Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në tri kopje, kopjen e pare ia dorëzon palës.
- Furnizon –tërheqë dhe jep triskat për lëndë djegëse dhe evidencën e tyre.
- Udhëheqë ditarin e arkës veçmas për karburante.
- Të hyrat e gatshme i dorëzon në bankë-xhiro llogarinë e Ndërmarrjes, pa vonesë.
- Përpilon ditarin e arkës për çdo ditë mbi të hyrat dhe të dalurat dhe ia bashkangjet dokumentacionin në gjendje të rregullt, i verifikuar nga personat e autorizuar.
- Çdo pagesë në favor apo barrë në të gatshme e evidenton në urdhëresat "inkasoni-paguani"
- Është i obliguar që t'i përmbahet maksimumit të mjeteve financiare të arkës për të cilin bien vendim organi kompetent.
- Çdo ditë i raporton Përgjegjësit financiar të shërbimit për gjendjen në arkë.
- Llogarit të ardhurat personale dhe kametat e të ardhurave i dorëzon në bankë
- Mban përgjegjësi për pagesën e dokumenteve të cilat nuk janë të vërtetuara nga personat e autorizuar, që janë në kundërshtim me ligjin.
- Kryen edhe punë tjera me urdhërues të Përgjegjësit financiar, Kryeshefit Ekzekutiv
- Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin për punësim dhe të njëjtit t'ia bashkëngjitin këto dokumente:

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Shkolla e mesme ekonomike, përparësi diploma Universitare, Fakulteti Ekonomik, Ekuivalent me Financa
 - 1 vite përvojë pune.
 - njohja e punës me kompjuter.
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
 - Dëshmi të përvojës në punë
 - Certifikatën që nuk është nën hetime
- Aplikacionet merren në zyrat qendrore të KRM "AMBIENTIT" SH.A në Pejë, konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në shtypin ditorë.
- Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara dorëzohen në zyrat qendrore të KRM "AMBIENTIT" SH.A, në pliko të mbyllur.



Kompania Rajonale për Mbeturina "AMBIENTI" – Zyrat Qendrore "Xhem Sadria" p.n. Pejë
Njësitë Operative: Pejë, Klinë e Istog

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës, dhe në përputhje me Rregulloren e brendshme Nr.015, mbi marrëdhënien në punë të punëtorëve, Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "AMBIENTIT" SH.A. Pejë publikon këtë :

KONKURS

Pozita: Inkasant/e

Detyrat dhe përgjegjësit:

Nën mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv, Menaxherit të Njësisë Operative k.k. Klinë është përgjegjës për:

- Bënë inkasimi nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe ngarkohet materialisht me fatura sipas rrugëve dhe rajoneve.
- Për çdo ditë dorëzon pazarin ditor dhe ngarkohet me fatura.
- Plotëson fletë dorëzimin mbi kryerjen e pagesave me shënimet e duhura.
- Përcjell gjendjen në teren për zbulimin e sipërfaqeve në sektorin private dhe
- bëjnë evidencën e tyre dhe me shkrim e informon shefin e shërbimit.
- Është i obliguar që të përcjellë ndërrimin e pronarit të banesave, shtëpive dhe të merr shënimet të cilat i dorëzon shërbimit komercialo-financiar.
- Është i obliguar që për çdo parregullsi në fatura, t'i kthej në rillogaritje.
- Obligohet që në teren të sillet korrekt dhe të mban uniform apo shenjë identifikimi të Ndërmarrjes.
- Kryen edhe punë tjera me urdhërues të Shefit të inkasantëve, përgjegjësit Financiar dhe Kryeshefit Ekzekutiv
- Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin për punësim dhe të njëjtit t'ia bashkëngjitin këto dokumente:

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Shkolla e mesme
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
 - Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.);
 - 1 vite përvojë pune- Dëshmi të përvojës në punë
 - Certifikatën që nuk është nën hetime
- Aplikacionet merren në zyrat qendrore të KRM "AMBIENTIT" SH.A në Pejë, konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në shtypin ditorë.

Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara dorëzohen në zyrat qendrore të KRM "AMBIENTIT" SH.A, në pliko të mbyllur.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Lejla Mavriqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Ekonomike "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

Njoftim për mbrojtje publike të Punimit të Doktoratës

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 13.07.2021,

(e martë), prej orës 11:00, në Fakultetin Ekonomik (

salla e profesorëve), kandidatja Msc. Arta Jashari Goga

i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës

me temën: "Ndikimi i praktikave të menaxhimit të

resurseve njerëzore në qëndrueshmërinë e biznesit", me

mentor Prof. Dr. Enver Kutllovci, para komisionit

profesional, në përbërje prej:

Prof. Asoc. Dr. Besnik Krasniqi- kryetar i komisionit,

Prof.Asoc. Dr. Ymer Havolli- anëtarë i komisionit,

Prof. Asoc. Dr. Selajdin Abdul- anëtarë i jashtëm i

komisionit (Universiteti i Evropës Juglindore- Tetovë)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr. 464-3/18
Datë: 01.07.2021

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016 Prishtinë, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 datë 26.09.2008, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

V E N D I M

I. MIRATOHET shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohen nga projekti për ndërtimin e segmenteve rrugore "Afrim Zhitia" dhe "Mbreti Zog" në Lipjan, sipas tabelave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërse të këtij vendimi.

II. Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 Tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Spektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetatat me tirazh më të madh.

I'u dërgohet:
-të gjitha Drejtorive
-Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



1


Përshkrimi i detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronësim për rrugën "Afrim Zhitia" në Lipjan

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re				
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²	Sipërfaqe për rrugë m ²
1	Liridon (Shukri) Ibrahim	002291-3 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	600	Gjerëtanishmi	E re		565	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		35
2	Liridon (Shukri) Ibrahim	02291-4 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	500	Gjerëtanishmi	E re		480	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		20
3	Qëndrim (Shukri) Ibrahim	02291-5 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	450	Gjerëtanishmi	E re		432	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		18
4	Liridon (Shukri) Ibrahim	02291-6 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	450	Gjerëtanishmi	E re		433	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		17
5	"Gashi Invest-BI" Sh.P.K	02291-2 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	2456	Gjerëtanishmi	E re		1867	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		589
6	Zdravkoviq (Novice) Zhivorad	00541-0 ZK Lipjan	Arë e kl.4	4899	Gjerëtanishmi	E re		4826	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		73
7	Muhamrem (Hamit) Limani	00540-10 ZK Lipjan	Arë e kl.4	500	Gjerëtanishmi	E re		426	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		74
8	Naim (Jahir) Jahiri	00539-6 ZK Lipjan	Arë e kl.4	600	Gjerëtanishmi	E re		576	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		24
9	Hazbi (Hasan) Bytyqi	00539-7 ZK Lipjan	Arë e kl.4	941	Gjerëtanishmi	E re		933	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		8
10	Bajram (Sabir) Gashi	00539-13 ZK Lipjan	Rrugë private	113	Gjerëtanishmi	E re		81	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		32
11	Fatmir (Mustaf) Shuhini	00539-23 ZK Lipjan	Arë e kl.4	403	Gjerëtanishmi	E re		371	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		32
12	Bajram (Sabir) Gashi	00538-13 ZK Lipjan	Rrugë private	113	Gjerëtanishmi	E re		2	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		111


Përshkrimi i detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronësim për rrugën "Mbreti Zog" në Lipjan

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re				
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²	Sipërfaqe për rrugë m ²
1	"Gashi Invest-BI" Sh.P.K	01889-1 ZK Lipjan	Oborr, shtëpi	406	Gjerëtanishmi	E re		274	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		132
2	Bajram (Sabir) Gashi	02132-3 ZK Lipjan	Oborr, shtëpi, arë e kl.1	2646	Gjerëtanishmi	E re		2230	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		416

2



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN


KRYETARI I KOMUNËS

NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës INr.464-35834 datë 01.07.2021 njoftohen të gjithë subjektet të përshkruar në Vendimin e bashkangjitur të këtij njoftimi se:

- Për arritjen e qëllimit publik për realizimin e projektit për ndërtimin e segmenteve rrugore "Afrim Zhitia" dhe "Mbreti Zog" në Lipjan, mbas plotësimin të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 datë 28.10.2010, me të cilin miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohen nga projekti për ndërtimin e segmenteve rrugore "Afrim Zhitia" dhe "Mbreti Zog" në Lipjan, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqet e tyre, e cila tabelë është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- Kryetari i Komunës do të marrë një Vendim Preliminar brenda periudhës prej 30-ditëve kalendrike pas përbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010, lidhur me organizimin e dëgjimeve publike.
- Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin shpronësues, brenda 10 ditëve kalendrike, mbas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës INr.464-35834 datë 01.07.2021, për miratimin e kërkesës për shpronësim ditën e publikimit në njërin nga gazetatat me tirazh më të madh në Kosovë.
- Kryetari i Komunës do të mbaj një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar për realizimin e projektit për ndërtimin e segmenteve rrugore "Afrim Zhitia" dhe "Mbreti Zog" në Lipjan.
- Të gjithë personat që janë zyrtar publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronar ose zotërues të interesit në pronën e cila gjindet në këtë pjesë ose avokat apo përfaqësues i ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.
- Çdo person i interesuar do t'i jepet mundësi e arsyshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2,3,4 të nenit 9 të Ligjit Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28.10.2010.
- Çdo person i interesuar i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjell me vete prova të arsyshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotërues i Interesit.
- Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave tjera në pronat e paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Lipjanit, do të mbahet me datë 14.07.2021 (e Merkurë) në ora 10⁰⁰, në objektin Komunës së Lipjanit- salla e Kuvendit.
- Në rast se prona është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimin të incuar në përputhje me at kërkesë asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmisimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përbushjes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 datë 28 tetor 2010. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj Ligjin Nr.03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 Tetor 2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e drejtave të tyre sipas ligjit.
- Çdo person i cili nuk është emruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilendo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikura të çfarëdo dokumenti që ndërlidhen në atë pretendim.

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

PRESDNIK OPŠTINE

1Br. 464-3583
Dana: 01.07.2021

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4, člana 7 i člana 8, stav 5 zakona Br.03/L-139 Ekspropriaciju nepokretne Imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. / Prishtinë/Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 stavove člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Nr.20/21 Juni 2016 Prishtinë, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipjan 1Br.110-623 dt 26.09.2008, Predsednik Opštine Lipjan donosi:

ODLUKA

I. Usvaja se se dalje rasprave zahteva za ekspropriaciju za javni interes nepokretne imovine vlasnika i posedovanja koje se utiče od projekta za izgradnje putni segmenta "Afrim Zhitia" i "Mbreti Zog" u Lipjan, prema tabelama opisane iz nadležne katastarske evidencije za titulara nepokretne imovine, njihovo pozicije u okviru projekta javnog interesa kao i njihovo površina tabele koje su deo ove Odluke.

II. Vrednost kompenzacije imovine se određuje od Kancelarije za Procenjivanje Nepokretne Imovine u Okviru Ministarstva Financije Republike Kosova u skladu sa Zakonom Br.03/L-139 za ekspropriaciju nepokretne imovine, sa dopunama i promenama obavljene u Zakonu Br.03/L-205 dt 28 Oktobra 2010 i Administrativnog Upustva Br.02/2015 za usvajanje načina i kriterijumima tehničkih procenjivanja iznosa za nepokretnu imovinu i štete koje se stvaraju u ekpropriaciji.

III. Za sprovođenje ove Odluke: Kancelarija Predsednika-Pravno Imovinski Sektor, Direktor za Urbanizam Planiranje i Zaštite Sredine, Direktorat za Geodeziju i Katastar i Direktorat Javne Usluge.

IV. Odluka stupa na snagu dana objavljivanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljivanje u nekoj novini sa velikim tiražom.

Dostaviti:

- Svim Direktoratima
- Arhivi Opštine

PRESDNIK OPŠTINE



1

Detaljni opis katastarskih parcela prema certifikate-katastarske jedinice za ekspropriaciju za put "Afrim Zhitia" u Lipjan.

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re				
Nr.	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Površina m ²	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Ostatak Površine m ²	Površina za Put m ²
1	Liridon (Shukri) Ibrahim	002291-3 ZK Lipjan	Njiva e kl.2 i 4	600	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	565	35
2	Liridon (Shukri) Ibrahim	02291-4 ZK Lipjan	Njiva e kl.2 i 4	500	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	480	20
3	Qëndrim (Shukri) Ibrahim	02291-5 ZK Lipjan	Njiva e kl.2 i 4	450	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	432	18
4	Liridon (Shukri) Ibrahim	02291-6 ZK Lipjan	Njiva e kl.2 i 4	450	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	433	17
5	"Gashi Invest-Bf" Sh.P.K	02291-2 ZK Lipjan	Njiva e kl.2 i 4	2456	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	1867	589
6	Zdravković (Novice) Zhivorad	00541-0 ZK Lipjan	Njiva kl.4	4899	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	4826	73
7	Muahrrem (Hamit) Limani	00540-10 ZK Lipjan	Njiva kl.4	500	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	426	74
8	Naim (Jahir) Jahiri	00539-6 ZK Lipjan	Njiva kl.4	600	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	576	24
9	Hazbi (Hasan) Bytyqi	00539-7 ZK Lipjan	Njiva kl.4	941	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	933	8
10	Bajram (Sabit) Gashi	00539-13 ZK Lipjan	Privatni put	113	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	81	32
11	Fatmir (Mustaf) Shahini	00539-23 ZK Lipjan	Njiva kl.4	403	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	371	32
12	Bajram (Sabit) Gashi	00538-13 ZK Lipjan	Privatni put	113	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	2	111

Detaljni opis katastarskih parcela prema Certifikatima- kadastrske Jedinice za ekspropriaciju za put "Mbreti Zog" u Lipjan

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re				
Nr.	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Površina m ²	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Ostatak Površine m ²	Površina za Put m ²
1	"Gashi Invest-Bf" Sh.P.K	01889-1 ZK Lipjan	Dvoriste,kuqa-zgrada	406	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	274	132
2	Bajram (Sabit) Gashi	02132-3 ZK Lipjan	Kuqa-zgrada, njiva kl.1	2646	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	2230	416

2



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

PRESDNIK OPŠTINE

OBAVEŠTENJE

Na osnovi stava 7.3 člana 8 Zakona Br.03/L-139 za ekspropriaciju nepokretne imovine sa promenama i dopunama obavljene sa Zakonom Br.03/L-205 i Odluke predsednika Opštine 1Br.464-35834 dana 01.07.2021 obaveštavamo sve subjekte opisane u Odluci zajedno sa ovom odlukom sa Obaveštenjem:

1. Za postizanje javne namere za realizovanje projekata za izgradnje putni segmenta "Afrim Zhitia" i "Mbreti Zog" u Lipjan, nakon ispunjavanja svih uslova u stavu 1 člana 4 Zakona Br.03/L-139 dana.26.03.2009 za Ekspropriaciju Nepokretne Imovine, sa promenama i dopunama u Zakonu Br.03/L-205 dt 28.10.2010, Opština u sprovođenje gorenavedenog zakona usvojila, prema tabeli opisane iz katastralnih evidencijama za vlasnike nepokretni imovina njihovo pozicija u okviru javne interesakai i njihova površina tabela je deo ovog Odluke.

2. Predsednik Opštine doneče Predhodnu Odluku u roku od 30-kalendarskih dana nakon ispunjavanja uslova određenih sa članom 9 Zakonom Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za ekspropriaciju nepokretne imovine, sa dopunom i promenom obavljene u Zakonu Br.03/L-205 dt 28.10.2010, oko organizovanja javnih debata.

3. Svako interesovana stranka ima prava da dostavlja pismena komentere oko predloženog ekspropriaciju od organa ekspropriacije u roku od 10 kalendarskih dana nakon objavljivanja Odluke Predsednika Opštine 1Br.464-35834 dana 01.07.2021, za usvajanje zahteva za ekspropriaciju dana objavljivanja u jednom novini sa najvećim tiražom na Kosovu.

4. Predsednik Opštine će održati janu debatu oko tražene ekspropriacije za realizovanje od projekata za izgradnje putni segmenta "Afrim Zhitia" i "Mbreti Zog" u Lipjan.

5. Svi zainteresovana lica koji su službenici Opštine, u koju se održava javna debata ili vlasnici, interesovana lica koja se nalazi na ovom delu ili advokat, predstavnik imaju pravo da učestvuju na javnu raspravu.

6. Svako interesovano lice dače mu se mogućnost da bi dao njegovo mišljenje usmeno oko ekspropriacije u skladu sa stavovima 2,3,4 član 9 të Zakona Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za ekspropriaciju nepokretne imovine, sa dopunama i promenama obavljena sa Zakonom Br.03/L-205 dt 28.10.2010.

7. Svako zainteresovano lice koji želi da učestvuje ili da svoje mišljenje u javnu debatu treba da dostavi sa sobom opravdane (dokumente) koje svedoče da je slušbeno Lice, vlasnik, ili avokat ili Zakonski Predstavnik tog slučbenog lica, vlasnika ili drugih.

8. Javna rasprava oko predloženog ekspropriacije, prava vlasništva ili drugih prava u nepokretne imovine koje se nalaze unutar teritorialne vlasništvo Opštine Lipjan će se održati **dana 14.07.2021 u 10⁰⁰, Objektu Opštine Lipjan - sala Skupštine.**

9. U slučaju da imovina je objekat zahteva, se ekspropriiše na osnovu procedure ekspropriacije inicirane u skladu sa tim zahtevom nijedno kompenzacija neće se isplatiti za troškove ili vrednost nekih popravki obavljeno u imovinu, građevinskih objekata ili proširenje objekata u imovinu, ili voča l ostalih biljka nasadenih nakon dana ispunjavanja stavova stava 8 člana 8 Zakona Br.03/L-139 za ekspropriaciju nepokretne imovine sa dopunama i promenama sa Zakonom br.03/1-205 dt 28 Oktobar 2010. Svako lice koje namerava da ima interes ili neki drugi interes na imovinu savetuje se da razmotri Zakon Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za ekspropriisanju nepokretne imovine obavljene u Zakonu Br.03/1-205 dt 28 Oktobar 2010, i da traži pravnu pomoć da bi razumeo svoja Zakonska prava.

10. Svako lice koje nije imenovan sa obaveštenjem i da smatra da ima imovinski interes ili drugi u nekoj parceli nepokretne imovine opisane u Obaveštenju odmah treba da dostavi u Organu ekspropriisanje jedno opisivanje njegove tvrdnje pravno osnovu tog tvrđenja kao i kopije svakakvih dokumentacija koje je vezano sa tim trdenjem.

PRESDNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULË

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues